



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

RAPORTI I STUDIMIT

**“TË MITURIT NË KONTAKT ME LIGJIN
DHE EFEKTET E ZBATIMIT
TË DREJTËSISË RESTAURUESE
DHE NDËRMJETËSIMIT”**



Tiranë, 2015

Ky studim është realizuar në kuadër të projektit “Institucionalizimi i Drejtësisë Restauruese dhe Ndërmjetësimit Viktimë-Kundërvajtës për të Miturit në Shqipëri”, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga organizata Save the Children në partneritet me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e të dy organizatave dhe BE si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children dhe FZKPM.

Përmbajtja e këtij botimi dhe pikëpamjet e shprehura në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Grupi realizues i studimit

Dr. Brunilda Zenelaga

Dr.Irida Agolli

MA. Oltion Kadaifçiu

Redaktor gjuhësor

Pandeli Koçi

TABELA E PËRMBAJTJES:

1. HYRJA	5
2. Ç'ËSHTË NDËRMJETËSIMI DHE DREJTËSIA RESTAURUESE?	6
3. METODOLOGJIA.....	9
3.1. Komponentët e kërkimit	9
3.2. Metodatat studimore.....	9
3.3. Shtrirja gjeografike e studimit	10
3.4. Kampionimi.....	11
3.5. Disa faktorë kufizues në kryerjen e studimit.....	11
4. ANALIZA E GJETJEVE	13
4.1. Analiza e të dhënave sasiore	13
4.1.1 Profili social dhe familjar i të miturve dhe të rinjve dhe përfshirja në programet e drejtësisë restauruese.....	13
4.1.1.1. Profili social dhe familjar i të anketuarve.....	13
4.1.1.2. Konflikti, sjellja devijante, dënimi.....	17
4.1.1.3. Recidivistët	20
4.1.1.4. Përfshirja në programet e drejtësisë restauruese.....	20
4.1.2. Informacioni dhe perceptimi për drejtësinë restauruese. Krahasim i perceptimeve mes kategorive sociale të bashkësisë rome, të mitur dhe të rinj në paraburgim dhe të rinj në shkolla.....	22
4.2. Analiza e të dhënave cilësore.....	33
4.2.1. Të dhëna të përftuara nga intervistat	33
4.2.1.1. Efekti i drejtësisë restauruese te të miturit e përfshirë në sistemin penitenciar... 33	
4.2.1.2 Njohja e faktorëve që lidhen me recidivizmin, parakusht për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese.....	35
4.2.1.3. Rëndësia e njohjes së faktorëve mbrojtës të brendshëm të të miturve për zbatimin e drejtësisë restauruese te të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin.....	36
4.2.1.4. Rëndësia e njohjes së faktorëve mbrojtës të jashtëm për zbatimin e drejtësisë restauruese te të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin	37

4.2.1.5. Ndërhyrjet që ndikojnë në uljen e recidivizmit te të miturit. Drejtësia restauruese, një mënyrë frytshme	39
4.2.2. Raste studimore të zgjidhjes së konflikteve sipas programit të drejtësisë restauruese.....	41
5. PËRFUNDIME	47
6. REKOMANDIME.....	50
7. BIBLIOGRAFIA	53
8. SHTOJCA.....	55

1. HYRJA

Ky studim është zhvilluar në kuadrin e projektit dyvjeçar “Zhvillimi institucional i Drejtësisë Restauruese dhe i Ndërmjetësimit Viktimë-Kundërvajtës për të Miturit në Shqipëri”, i zbatuar nga Organizata Save the Children dhe Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri dhe Save the Children Norvegji.

Studimi u zhvillua në vitin e dytë të këtij projekti dhe synoi të eksplorojë ndikimin e ndërmjetësimit dhe të drejtësisë restauruese të të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin, duke analizuar situatën konkrete në Shqipëri.

Synimi i këtij studimi është në funksion të objektivit të përgjithshëm të projektit të sipërpërmendur, i cili është: Krijimi i aksesit në drejtësinë restauruese për të miturit në kontakt me ligjin, sidomos për grupet e marginalizuara, përmes rritjes së kapaciteteve të aktorëve institucionalë dhe të shoqërisë civile në fushën e drejtësisë restauruese.

Studimi ka në fokus vlerësimin e përfshirjes së të miturve dhe të rinjve në programin e drejtësisë restauruese, si dhe impaktin që ka pasur ofrimi i këtyre programeve të të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin.

Objektivat e këtij studimi janë:

- Të përshkruhet profili social dhe familjar i të miturve dhe të rinjve që janë të përfshirë ose të prirur për t'u përfshirë në situata konfliktuese, si dhe marrëdhënia e këtij profili me shkallën e njohjes dhe të përfshirjes në programin e drejtësisë restauruese.
- Të krahasohen qëndrimet e tri kategorive sociale të të miturve dhe të rinjve: anëtarë të bashkësisë rome, të mitur dhe të rinj në seksionet e paraburgimit në Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (I.E.V.P) dhe nxënës shkollash, në lidhje me perceptimin për drejtësinë restauruese.
- Të analizohet perceptimi i profesionistëve të fushës së drejtësisë së të miturve për impaktin e shërbimit të ndërmjetësimit dhe të drejtësisë restauruese në shmangien e fëmijëve dhe të rinjve nga sistemi penitenciar dhe në uljen e recidivizmit.
- Të paraqiten rekomandime dhe sugjerime për mënyrat e frytshme për vënien në zbatim të drejtësisë restauruese në Shqipëri, dhe për rolin dhe detyrat e veçanta që duhet të kenë institucione të caktuara për të realizuar këtë proces.

2. Ç'ËSHTË NDËRMJETËSIMI DHE DREJTËSIA RESTAURUESE?

Shmangia (ose devijanca) mund të përcaktohet si moskonformizëm ndaj një norme të caktuar ose ndaj një tërësie normash, të cilat janë të parapëlqyera nga një numër i madh njerëzish të një bashkësie ose shoqërie (Giddens, 2004: 122). Veprimtaritë devijante jo gjithmonë janë veprimtari kriminale, sepse këto të fundit i referohen shkeljes së disa normave të një rëndësie parësore për ekzistencën e një shoqërie. Në këtë kontekst, mënyra se si duhen trajtuar njerëzit që kryejnë krime, nga ata që kryejnë sjellje devijante të një rrezikshmërie jo të lartë shoqërore, duhet të jetë e ndryshme. Për kategorinë e parë zakonisht vepron drejtësia penale, ndërsa për të dytën, gjithnjë e më shumë po flitet për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin. Por ç'është drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi?

Në nenin 1 të ligjit shqiptar “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, sanksionohet: “Ndërmjetësimi është një veprimtari jashtëgjyqësore, në të cilin palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjanes (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin” (Ligji 10385, datë 24.02.2011).

Mjaft studiues mendojnë se ndryshimi rrënjësor ndërmjet gjyqimit dhe ndërmjetësimit gjendet që në fillesën latine të këtyre dy fjalëve. Lidhur me këtë çështje, ndër të tjerë, R. Sabato ka shkruar: “me ndërmjetësue” nënkupton ndërhyrjen e dikujt që kërkon një qëndrim “të mesëm” ose ndërmjetës që, në të vërtetë, do të jetë ndërmjet dy qëndrimeve të skajshme, në të cilat ndodhen palët; rrënja e saj ka edhe kuptimin “me shërue” ose “me mjekue”: pra të mbledhura së bashku fjala “ndërmjetësim” do të nënkuptojë metodën me të cilën u drejtohem palëve për të rregulluar atë çka ka bërë që marrëdhëniet e tyre të ndërpriten, duke u munduar që palët të rivendosin marrëdhëniet e tyre të mëparshme (Shih: Dervishi, 2002: 26-27).

Kështu pra, ndërmjetësimi konsiderohet një proces, një formë alternative zgjidhje mosmarrëveshjes jashtë rrugës gjyqësore. Pothuajse të gjitha përcaktimet rreth ndërmjetësimit orientohen në një element të përbashkët, siç është roli i ndërmjetësit si një person i tretë asnjanes, i paanshëm që lehtëson komunikimin ndërmjet palëve për arritjen e marrëveshjes në respektim të vullnetit të lirë të tyre.

Ndërmjetësimi është një alternativë e zgjidhjes së konflikteve me marrëveshje, me pëlqim, me falje. Në rast se palët nuk janë të kënaqura me pasojat e ndërmjetësimit, mund t'u drejtohen alternativave të tjera të zgjidhjes së konflikteve, si asaj gjyqësore, arbitrazhit, ankimit administrativ etj. Sipas ligjit për ndërmjetësim, ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë (Semini, 2011:8-12).

Ndërmjetësimi dhe drejtësia restauruese janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën, sepse janë pjesë e të njëjtit proces. Drejtësia restauruese duhet të synojë që ndëshkimi i të akuzuarit

të luajë një rol riedukues dhe rehabilitues, për ta kthyer të akuzuarin, pas vuajtjes së dënimit, në një pjesëtar të qytetëruar të bashkësisë, që nuk do t'i rikthehet krimit dhe burgut. Drejtësia restauruese e vendos si viktimën, ashtu edhe shkelësin, në ndikimin e zgjidhjes së problemeve, duke u përqendruar në përmirësimin e raportit midis humbjeve materiale dhe humbjeve psikologjike.

Megjithëse i vështirë, dialogu dhe marrëveshja shërbejnë si elemente qendrore dhe të mundshme të restaurimit të drejtësisë. Ky është pikërisht thelbi kryesor i lehtësimit të pasojave të krimit, me gjithë rritjen e numrit të shkelësve dhunues (Semini, 2011:8-12).

Programet e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit për trajtimin e të miturve dhe të rriturve në kontakt me ligjin janë bërë pjesë e suksesshme e drejtësisë penale në shumë vende të Europës. Synimet e këtyre programeve, sipas praktikueseve të kësaj alternative, janë të shumta dhe i përgjigjen në kohë riparimit të dëmeve të shkaktuara nga vepra penale, ndikojnë pozitivisht në proceset edukative dhe parandaluese, si dhe në kuptimin e drejtë të përgjegjësisë së autorit.

Si të tilla po rendisim dy programe ose modele restauruese më kryesore:

1. *Programet e ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës:* Në këto programe, përmes rolit të ndërmjetësve të licencuar, synohet që të realizohet takimi i viktimës dhe kundërvajtësit për të diskutuar nga perspektiva e secilit shkeljen dhe pasojat e ardhura prej saj si edhe mundësitë dhe hapat e nevojshëm për të korrigjuar dëmin e shkaktuar.
2. *Programet e takimit gjithëpërfshirës ose ndryshe të takimit në grup* janë të ngjashme me ndërmjetësimin viktimë-kundërvajtës, por ndryshon në atë që ata përfshijnë jo vetëm shkelësin dhe viktimën, por edhe anëtarët e familjeve të tyre përkatëse dhe përfaqësuesit e bashkësisë.

Ndërmjetësimi mund të funksionojë në çdo fazë të konfliktit. Ai mund të jetë i ndërthurur me një paralajmërim nga policia, të shfaqet paralel me ndjekjen penale, mund të ofrohet gjatë një dënimi ose pas tij etj. Një çështje e rëndësishme është, nëse ndërmjetësimi do të ndikojë ose jo në vendimet gjyqësore.

Sistemi i drejtësisë restauruese ndihmon në përmbushjen e disa nevojave kryesore të autorëve të veprave penale, si p.sh.:

- Të kuptojnë dhe të marrin përgjegjësitë e tyre për dëmin e kryer.
- Të përmirësojë situatën e tyre, duke shmangur sjelljet kriminale.
- Transformimi vetjak i ndjenjave, veçanërisht për turpin që mund të ndiejnë për veprimet dhe dëmin e shkaktuar.
- T'i inkurajojmë dhe t'i integrojmë në jetën në bashkësi (Gjoka, 2011: 77-78)

Nëpërmjet drejtësisë restauruese:

- Autorët, që ndihen fajtorë për veprimet e tyre, kanë mundësinë t'u kërkojnë falje viktimave.

8 *Të miturit në kontakt me ligjin dhe efektet e zbatimit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit*

- Autorët kanë mundësinë "...t'u shpjegojnë viktimave si dhe pse u sollën në atë mënyrë".
- Autorët e veprave penale janë përgjegjës dhe marrin përgjegjësinë e veprimeve të kryera ndaj viktimave.
- Autorët e veprave penale mund të dëmshpërblejnë viktimat për dëmin e shkaktuar (Po aty).

Në librin "Libri i vogël i Drejtësisë Restauruese", studiuesi Howard Zehr sqaron se "Drejtësia restauruese është një kompas dhe jo një hartë" (Howard, 2002:10). Sipas tij, lëvizja e Drejtësisë Restauruese filloi si një përpjekje për të ri-menduar nevojat që shkakton krimi, si dhe rolet e nënkuptuara në krim. Procesi i Drejtësisë Restauruese përmbush nevojat e viktimës, të autorit të veprës penale dhe të bashkësisë, gjë që s'mund të arrihet nëpërmjet sistemit të drejtësisë penale (Po aty).

3. METODOLOGJIA

3.1. Komponentët e kërkimit

Sikurse u përmend edhe më sipër, studimi ka në fokus vlerësimin e përfshirjes së të miturve dhe të rinjve në programin e drejtësisë restauruese, si dhe impaktin që ka pasur ofrimi i këtyre programeve te të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin.

Komponentët kryesorë të kërkimit:

- Përshkrimi i profilit social dhe familjar i të miturve dhe të rinjve që janë të përfshirë ose të prirur për t'u përfshirë në situata konfliktuese, si dhe marrëdhënia e këtij profili me shkallën e njohjes dhe të përfshirjes në programin e drejtësisë restauruese.
- Paraqitja e perceptimeve/opinioneve e të miturve dhe të rinjve të anketuar (sipas 3 kategorive: anëtarë të bashkësisë rome, të mitur dhe të rinj në seksionet e paraburgimit në I.E.V.P. dhe nxënës shkollash), për shkallën e njohjes se drejtësisë restauruese e ndërmjetësimit dhe qëndrimet e tyre për rëndësinë e përfshirjes në programet e drejtësisë restauruese.
- Analiza e perceptimeve të profesionistëve që punojnë me të mitur dhe të rinj në kontakt me ligjin, për impaktin e drejtësisë restauruese te kjo kategori sociale.
- Identifikimi i praktikave të mira dhe i studimeve të rastit të të miturve të përfshirë në praktikën e drejtësisë restauruese.

3.2. Metodën studimore

Mbledhja e të dhënave të këtij studimi mbështetet në një kombinim të metodave cilësore dhe sasore. Rishikimi i literaturës, si një hap i parë, shërbeu edhe për përgatitjen e instrumenteve dhe krijoi bazën për përgatitjen e kornizës së studimit.

Përdorimi i *metodës sasore* pati si qëllim që të merrte një informacion të përgjithshëm. Përdorimi i *metodës sasore* ndihmoi në gjetjen e asaj që është tipike, mesatare dhe që përfaqëson grupin e studimit.

Në fokus të pjesës sasore të këtij studimi ishin të miturit dhe të rinjtë e grupmoshës 14-18 dhe 19-21 vjeç, veçanërisht nga grupe vulnerabël që janë në sistemin e paraburgimit, nga bashkësia rome, si dhe të mitur dhe të rinj në shkolla ku është zbatuar programi i ndërmjetësimit ndërmjet bashkëmoshatarëve. Është zgjedhur kjo kategori moshore, jo vetëm se kjo kategori është pjesë e programeve të drejtësisë restauruese, por edhe sepse ndërhyrja me anë të programit të drejtësisë restauruese, si proces edukimi, te kjo kategori pritet të jetë më e frytshme.

Për një analizë më të thelluar është përdorur edhe metoda cilësore e mbledhjes së të dhënave.

Metoda cilësore përfshin procesin e intervistimit dhe atë të studimit të rasteve konkrete.

Metoda cilësore mund të përshkruhet si një model i efektshëm që ndodh në mjedisin e vet natyror dhe që i jep mundësi studiuesit të përfshihet shumë në përvojën aktuale (Creswell, W. 2003).

Procesi i intervistimit të drejtpërdrejtë (individuale dhe në fokus-grupe) synoi të merrte informacion të thelluar nga specialistët e fokusuar në punën me të mitur dhe të rinj që kanë kryer konflikte penale si: punonjës policie në komisarate dhe I.E.V.P, punonjës të kujdesit social në I.E.V.P, përfaqësues të bashkësisë rome, psikologë shkollash, mësues, punonjës në shërbimin e provës, instruktorë në Policinë e Shtetit, si dhe specialistë të tjerë në fushën e drejtësisë.

Instrumenti i përdorur për mbledhjen e këtyre të dhënave është një udhëzues (guidë) interviste gjysmë e strukturuar. Udhëzuesi përmban pyetje kyçe që orientoi procesin e intervistimit, por nga ana tjetër mundësoi hapësira për gjenerimin e ideve dhe të diskutimeve në një plan edhe më të gjerë. Të dhënat e përftuara përpunohen me anë të analizës tematike.

Rastet e studimit, gjithashtu, synuan të zbulonin në thellësi mënyrën sesi të miturit kanë përfituar nga drejtësia restauruese nëpërmjet ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës ose konferencës në grup, kjo në varësi të konflikteve penale në të cilat ata janë përfshirë. Gjithsej janë analizuar 3 raste studimore: një rast konflikti mes të miturve në shkollë, i referuar nga Policia e Shtetit, një rast i dytë i referuar nga përfaqësues të bashkësisë rome dhe, rasti i tretë, i referuar nga I.E.V.P. me të mitur në paraburgim.

Metoda sasiore e përdorur në këtë studim është ajo e anketimit, e cila si instrument ka një pyetësor të strukturuar. Në këtë proces anketimi morën pjesë të mitur të moshës 14-18 dhe 19-21 vjeç, të përfshirë në konflikte penale ku bëjnë pjesë: të mitur në I.E.V.P të ndryshme, në sektorë paraburgimi, por edhe të mitur të dënuar, të mitur, rastet e të cilëve janë referuar në komisarate policie, të mitur nga bashkësia rome, por edhe të rinj gjimnazistë të përfshirë në konflikte të natyrës së sipërpërmendur. Pyetësori përmban tri seksione të dhënash. Seksioni i parë synon të marrë informacion për të dhënat vetjake dhe ato familjare të të miturit, seksioni i dytë fokusohet në mbledhjen e të dhënave për situatën konfliktuale, sjelljen devijante dhe dënimin e të miturit dhe, seksioni i tretë, synon marrjen e informacionit për drejtësinë restauruese.

Përdorimi i tri metodave të mësipërme të studimit dhe analiza e të dhënave nga këto instrumente (trekëndëzimi) mundëson një nivel të lartë besueshmërie për studimin. Trekëndëzimi është në mënyrë tipike një strategji për përmirësimin e vlefshmërisë dhe të qëndrueshmërisë së kërkimit ose të vlerësimit të gjetjeve (Mathison, 1988). Trekëndëzimi përshkruan kombinimin e dy ose më shumë teorive, burimeve të të dhënave, metodave në një studim (Halcomb dhe Andrew 2005, Williamson 2005) dhe asiston me përpikëri ndërtimin logjik të studimit.

3.3. Shtrirja gjeografike e studimit

Studimi u realizua në qytetet: Tiranë, Vlorë, Durrës, Korçë, Elbasan, Shkodër dhe Lezhë. U përzgjedhën këto qytete, jo vetëm sepse gjeografikisht përfaqësojnë kontekstin shqiptar, por

edhe sepse në këto qytete shërbimi i ndërmjetësimit dhe programi i drejtësisë restauruese ofrohet përgjatë një periudhe të konsiderueshme kohore, duke krijuar kështu një “terren” sociologjikisht të përshtatshëm për eksplorimin e çështjes në fjalë.

3.4. Kampionimi

Për intervistat e drejtpërdrejta (individuale dhe në fokus-grupe) u përdor një kombinim mes kampionimit të volitshëm/të qëllimshëm dhe kampionimit “të ortekut të borës”. Në fillim të procesit të intervistimit u përshinë disa specialistë të fushës që përmbushin qëllimin e studimit (kampioni i qëllimshëm), të cilët më pas rekomantuan individë të tjerë që përmbushin të njëjtin qëllim (kampioni “ortek”).

U realizuan gjithsej 6 fokus grupe, si dhe intervista të lira me 80 specialistë të fushave të sipërpërmendura.

Në procesin e anketimit morën pjesë 1044 të mitur dhe të rinj. Përzgjedhja e kampionit ishte rastësore dhe pjesërisht e qëllimshme. Të miturit dhe të rinjtë në shkolla u përzgjedhën nga shkolla me nxënës me prejardhje heterogjene sub-kulturore, nga klasat më problematike, sipas orientimeve të mësuesve.

Tri rastet studimore të përshkruara në këtë studim janë përzgjedhur në mënyrë të kujdesshme nga rastet e trajtuara përgjatë programit të zgjidhjes së konflikteve me anë të ndërmjetësimit klasik, ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës, dhe konferencës në grup, program ky i ofruar nga Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” në vitin 2014 e në vazhdim.

Në to përshkruhen konflikte mes të miturve dhe të rinjve të grupmoshës 14-21 vjeç, si dhe mënyra se si këto konflikte janë menaxhuar nëpërmjet programit të sipërpërmendur.

3.5. Disa faktorë kufizues në kryerjen e studimit

Realizimi i këtij studimi pati disa faktorë kufizues.

Së pari, nga pikëpamja metodologjike, ishte e vështirë të ndërtohej një instrument që do të përdorej si nga kategoria e të miturve dhe e të rinjve të përfshirë në konflikte penale, si nga ata të prirur për t'u përfshirë në konflikte të përditshme.

Së dyti, numri i studimeve në këtë fushë, të cilat do të shërbenin si modele udhëzuese për studimin në fjalë dhe si pikënisje për hulumtimin me fokus ndikimin e drejtësisë restauruese te të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin, është i kufizuar. Ka disa studime për drejtësinë restauruese, por ato janë të pjesshme dhe synojnë të masin impaktin e drejtësisë restauruese në institucione të veçanta (si p.sh.: Shërbimi i Provës) dhe nuk janë studime gjithëpërfshirëse.

Së treti, pavarësisht se u synua që të anketoheshin të gjithë të miturit dhe të rinjtë në I.E.V.P.,

12 *Të miturit në kontakt me ligjin dhe efektet e zbatimit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit*

në sistemin e paraburgimit, pra të bëhej një anketim i llojit census, kjo gjë nuk u arrit në mënyrë të plotë për shkak të dinamikës që krijohet në këtë sistem si: mungesës së të miturve në çastin e anketimit për shkak të pjesëmarrjes së tyre në seancat gjyqësore, për shkak të takimeve me prindërit dhe të afërmit, si dhe për të respektuar vullnetin e të miturve për të marrë pjesë ose jo në anketim.

Së katërti, u hasën vështirësi në marrjen e mendimeve dhe të perceptimeve të thelluara në disa raste të intervistimit të drejtpërdrejtë. Një pjesë e të intervistuarve hezitonin të jepnin përgjigje të plota dhe shtruese, duke u kufizuar në dhënien e ideve sipërfaqësore.

4. ANALIZA E GJETJEVE

4.1. Analiza e të dhënave sasiore

4.1.1. Profili social dhe familjar i të miturve dhe të rinjve dhe përfshirja në programet e drejtësisë restauruese

4.1.1.1. Profili social dhe familjar i të anketuarve


Kjo pjesë e studimit ka qëllim të analizojë profilin social e familjar të të miturve dhe të rinjve që janë përfshirë në konflikte ose janë të prirur për t'u përfshirë në to, si dhe marrëdhënien që ky profil ka me shkallën e njohjes dhe të përfshirjes së tyre në programin e drejtësisë restauruese.

Për ta krijuar këtë kontekst është zgjedhur një qasje sasiore që bazohet në anketimin e 1044 të rinjve në disa qarqe të vendit. 7 anketa u konsideruan të pavlefshme për shkak të parregullsive në plotësimin e tyre dhe, për rrjedhojë, të dhënat e përfuara nga to janë konsideruar të pavlefshme. Në analizë janë përfshirë të dhënat e përfuara nga 1037 anketa.

Përmes analizës së të dhënave për moshën, gjininë, vendbanimin, gjendjen ekonomike, përfshirjen në konflikt është synuar të skicohet një profil social-psikologjik i të rinjve të anketuar përmes këtij studimi dhe për sa lejojnë mundësitë e përgjithësimit për të gjithë të rinjtë shqiptarë. Kampioni prej më shumë se një mijë të anketuarish dhe shpërndarja e të rinjve në një larmi të madhe kategorish, si këto që përmendëm më sipër e të tjera, na mundëson një pozitë të mirë për të nxjerrë përfundime që nuk kufizohen vetëm te të anketuarit.

Kategoritë moshore dhe gjinore të të anketuarve

Anketat e realizuar targetuan të rinj të grupmoshës 14 deri në 21 vjeç. Grupimi më i madh është i 17 deri 19-vjeçarëve që janë të përfaqësuar me 690 të anketuar ndër të gjithë kampionin. 129 ishin të grupmoshës 14 deri 16 vjeç, ndërsa 218 ishin të grupmoshës 20 deri 21 vjeç. Këto të dhëna, të shprehura në përqindje, janë paraqitur grafikisht në grafikun nr. 1.




Ndarja e grupit të anketuar në femra e meshkuj është pothuajse e barabartë, 50.2 për qind femra dhe 49.8 për qind meshkuj.

Grafiku nr.1: Grupmosha e të anketuarve

Kategori të tjera të të anketuarve

Të anketuarit, siç edhe u tregua edhe në hyrje të këtij studimi, u përzgjedhën mes të rinjve që ndiqnin shkollën, mes atyre që i përkisnin bashkësisë rome dhe atyre që gjendeshin të ndaluar në paraburgim dhe akuzoheshin për vepra të ndryshme të karakterit penal, si dhe të rinjve që kryenin dënimin. Një trajtim më i hollësishëm i karakteristikave të të anketuarve, sipas këtyre kategorive, do të vijojë në krerët e mëposhtëm, ndërkohë që këtu na mjafton të bëjmë të njohur, se sipas këtyre kategorive të rinjtë ndahen si vijon (Grafiku nr.2).



Grafiku nr.2: Kategoritë e të anketuarve

Origjina dhe vendbanimi

Për sa i përket origjinës së të intervistuarve në përzgjedhjen e kampionit, u bënë përpjekje që të kishte një përfaqësim të grupit të studimit. Në tabelën numër 1 gjendet shpërndarja e të anketuarve sipas qarqeve të origjinës:


Qyteti	Numri i të anketuarve	Frekuenca
Durrës	174	16.7 %
Tiranë	242	23.3%
Korçë	190	18.3%
Lezhë	41	4.0%
Shkodër	149	14.4%
Vlorë	137	13.3%
Elbasan	104	10.0%
Shuma	1037	100%

Tabela nr.1 : Origjina e të anketuarve

Për të plotësuar më tej pasqyrën e vendbanimit, u mbledhën edhe informacione mbi kategoritë e vendbanimit të të anketuarve. Në kategoritë sipas ndarjeve “qytet”, “fshat” dhe “periferi” u vu re një ndarje si vijon: 66 për qind e të anketuarve jetojnë në qytet, në fshat jetojnë 17.3 për qind e të anketuarve, ndërsa pjesa tjetër prej 16.7 për qind e të anketuarve jetojnë në periferi.

Vetëperceptimi për situatën ekonomike familjare


Duke analizuar perceptimin e situatës ekonomike të familjeve prej nga vijnë të rinjtë e anketuar, situata paraqitet si vijon:



Grafiku nr.3: Vetëperceptimi për nivelin e të ardhurave të familjes

Sikurse tregojnë mjaft studime, kur pyeten për nivelin e të ardhurave dhe përcaktimin e shtresës shoqërore, pjesa më e madhe e njerëzve pëlqejnë të vetëklasifikohen si anëtarë të shtresës së mesme, me një nivel mesatar të ardhurash (Giddens, 2004: 225-226), por kjo në kontekstin shqiptar është e diskutueshme, prandaj kjo e dhënë duhet marrë në konsideratë me shumë rezerva.

Ndërkohë që brenda targetit të përgjithshëm situata e atyre që janë të dënuar për ndonjë shkelje të ligjit paraqitet disi më e vështirë. Ata që raportojnë të ardhura të pakta brenda këtij grupimi janë 25 për qind kundrejt 17 për qind e atyre që raportojnë të ardhura të pakta në targetin e përgjithshëm. Ndërkohë që një rënie në 9 për qind mund të shihet edhe në numrin e atyre që raportojnë të ardhura shumë të mira.



Grafiku nr.4: Vetëperceptimi për nivelin e të ardhurave të familjes për kategorinë e të miturve dhe të rinjve në paraburgim

Struktura familjare

Një vëmendje e veçantë në pyetësor iu kushtua strukturës së familjes të të anketuarve, me qëllim që të eksplorohej në një farë mënyre ndikimi që struktura e familjes ka në shpeshhtësinë me të cilën të rinjtë përfshihen në konflikte ose shkelle më të rënda që dënohen prej ligjit. Rreth 68 për qind e të gjithë të miturve dhe të rinjve të anketuar kanë pohuar se jetojnë me të dy prindërit. Në këtë kategori përfshihen dhe të rinjtë dhe të miturit që kanë pohuar se jetojnë dhe me motra dhe vëllezër, si dhe me gjyshër në disa raste. Afro 23 për qind e të gjithë të anketuarve kanë pohuar se jetojnë me një prind të vetëm (janë përfshirë këtu edhe ata që kanë pohuar se jetojnë edhe me motra dhe vëllezër dhe gjyshër në ndonjë rast) dhe 9 për qind e të gjithë të anketuarve kanë dhënë përgjigje të tjera.

Interesant paraqiten gjetjet për strukturën familjare të të miturve dhe të rinjve të anketuar në sektorët e paraburgimit në I.E.V.P. Rreth 76 për qind e të anketuarve në paraburgim kanë pohuar se jetojnë me të dy prindërit, afro 17 për qind e tyre kanë pohuar se jetojnë vetëm me njërin prind dhe rreth 7 për qind kanë dhënë përgjigje të tjera.

Këto të dhëna nuk nxjerrin në pah ndonjë domethënie të ndikimit të strukturës familjare në mundësinë e përfshirjes së të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin. Megjithatë këto të dhëna nuk depërtojnë në problematikat e familjes që mund të ndikojnë në përfshirjen e të miturve dhe të rinjve në konflikte dhe kundërvajtje penale, për shembull në lidhje me marrëdhëniet mes prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, prandaj duhen marrë në konsideratë në mënyrë të kufizuar.

Arsimi

Studimi nxori në pah se pjesa më e madhe e të anketuarve kanë përfunduar nivelin arsimor 9-vjeçar. Afro 61 për qind e të anketuarve kanë dhënë këtë përgjigje. Rreth 30 për qind e të anketuarve kanë pohuar

se kanë përfunduar arsimin e mesëm. Mes tyre kishte dhe një kategori studentësh universitarë që e kanë kategorizuar veten si me arsim të lartë (rreth 14 për qind), por gjatë përpunimit të të dhënave, u mbajt parasysh kjo dhe u bë ndryshimi i duhur në lidhje me nivelin arsimor të përfunduar të të anketuarve.

Afro 6 për qind e të anketuarve kanë pohuar se kanë përfunduar arsimin fillor, ndërsa rreth 3 për qind e kategorizojnë veten “pa arsim”.

Studimi nxori në pah se përgjithësisht të miturit dhe të rinjtë nga qyteti kanë nivel arsimor më të lartë se ata që jetojnë në fshatra ose në zonat periferike.

Deri tani janë paraqitur në mënyrë deskriptive të dhënat për profilin social dhe familjar të të miturve dhe të rinjve që morën pjesë në studim. Më poshtë paraqitet një analizë në lidhje me përfshirjen e këtij targeti në konflikte dhe sjellje devijante, si dhe mënyra se si profili social dhe familjar ndikon në shkallën e njohjes dhe të përfshirjes në programin e drejtësisë restauruese.

4.1.1.2. Konflikti, sjellja devijante, dënimi

Profili i të anketuarve dhe shkalla e përfshirjes në konflikt dhe sjellje devijante

Të dhënat e studimit treguan se përgjithësisht përfshirja e vajzave në konflikte ose sjellje devijante është më e vogël në kahasim me atë të djemve. 274 vajza i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes “a jeni konfliktuar apo jeni përfshirë në sjellje devijante?”, ndërkohë që të rinjtë djem janë të përfaqësuar me 348 të anketuar që pranojnë të jenë konfliktuar ose të përfshirë në sjellje devijante.


Në shumën e përgjigjedhënësve ndaj pyetjes për konfliktimin ose sjelljen e devijante mësojmë se këto sjellje kanë qenë të drejtuara ndaj bashkëmoshatarëve, të rriturve, anëtarëve të familjes ose institucioneve. Përmasat e konfliktimit ose të sjelljes devijante, sipas secilës kategori, janë si vijon:

A jeni përfshirë në konflikte ose sjellje devijante kundrejt:	Vlera numerike e të anketuarve	Frekuenca në përqindje
Bashkëmoshatarëve	527	50.8%
Të rriturve	56	5.4%
Anëtarëve të familjes	30	2.9%
Institucioneve	9	0.9%
Nuk jam përfshirë	415	40.0%
Shuma	1037	100%

Tabela nr.2: Përfshirja në konflikte ose sjellje devijante

Ndër 30 të anketuarit që janë përgjigjur se janë përfshirë në konflikte me anëtarët e familjes, 23 janë vajza (ose afro 77 për qind e kësaj kategorie) dhe vetëm 7 djem (rreth 23 për qind e të

anketuarve që kanë dhënë përgjigjen se konfliktohen me anëtarë të familjes). Kjo, në një farë mënyre, tregon se kufizimi i sferës së veprimtarisë të disa vajzave vetëm në shtëpi, bëhet shkak për lindjen e konflikteve mes tyre dhe ndonjërit prej anëtarëve të familjes së tyre. Kjo e dhënë është paraqitur grafikisht më poshtë.



Grafiku nr.5: Përfshirja në konflikte me anëtarë në familje, sipas gjinisë


Megjithëse targeti i të anketuarave, që i kanë dhënë përgjigje pozitive kësaj pyetje, është i pakët, ajo që mund të aludojmë është se vajzat e reja përballen me një mjedis disi më armiqësor në familje. Atyre u duhet të konfliktohen më tepër se djemtë për të krijuar hapësirë për veprimet e qëndrimit e veta.

Një e dhënë interesante paraqitet ajo që lidhet me marrëdhënien e vendbanimit të të miturve dhe të rinjve të anketuar dhe shkallën e përfshirjes në konflikte dhe sjellje devijante. Në fshat numri i atyre që janë të përfshirë në konflikte është 102, ndërsa i atyre që jetojnë në qytet dhe janë të përfshirë në konflikte ose sjellje devijante është 421. Në periferi numri i të konfliktuarve është 94. Frekuenca e shprehur në përqindje për këtë të dhënë është paraqitur më poshtë:

Të përfshirë në konflikt ose kanë kryer sjellje devijante (kundrejt)	Vlera numerike e të anketuarve	Frekuenca në përqindje
Qytet	421	67.8%
Fshat	102	16.3%
Periferi	94	15.1%
Pa përgjigje	5	0.8%
Shuma	622	100%

Tabela nr.3: Të përfshirë në konflikte sipas vendbanimit

Përsa i përket marrëdhënies mes nivelit të të ardhurave familjare, nivelit arsimor dhe përfshirjes në konflikt të të miturve dhe të rinjve, vihet re se grupi i të miturve dhe të rinjve me arsim 9-vjeçar dhe të ardhura mesatare familjare ka pohuar më së shumti se përfshihet në konflikte në krahasim me grupet e tjera. Grafiku i mëposhtëm e paraqet këtë gjetje.




Grafiku nr.6 : Marrëdhënia mes gjendjes ekonomike, nivelit arsimor dhe përfshirjes në konflikt

Profili i të anketuarve, veprat penale dhe dënimi

Rreth 13.8 për qind e të anketuarve (të cilët janë nga sistemi i paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit) i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes se janë akuzuar për kryerjen e ndonjë vepër penale (ose janë dënuar për kryerjen e saj).

Ndër të miturit dhe të rinjtë e akuzuar dhe të dënuar, shkelja që haset më shpesh është ajo e vjedhjes. 70 ndër 148 të mitur dhe të rinj të akuzuar dhe të dënuar që morën pjesë në këtë studim, (rreth 47.2 për qind) janë të akuzuar ose të dënuar për këtë vepër penale. Vepra tjetër që haset më shpesh është ajo e plagosjes, e cila është raportuar prej 17 të anketuarish ose rreth 11.4 për qind e numrit të përgjithshëm të të akuzuarve dhe të dënuarve që morën pjesë në këtë studim. Për vepra penale të tjera që kanë pasur elemente të dhunës, kanë raportuar 4.7 për qind e numrit të përgjithshëm të të akuzuarve dhe të dënuarve që morën pjesë në këtë studim, ndërsa pjesa tjetër është angazhuar në krime si aksidente, drejtim automjetesh pa leje drejtimi, trafik lëndësh narkotike, marrëdhënie seksuale me dhunë etj.

Nëse shqyrtojmë marrëdhënien mes gjendjes ekonomike, nivelit arsimor dhe akuzës ose dënimit për kryerjen e një vepre penale, vihet re se grupi që ka raportuar se ka arsim 9-vjeçar dhe të ardhura mesatare mujore, përbën grupin më të madh të të miturve dhe të rinjve që janë akuzuar ose dënuar për kryerjen e një vepre penale. Grafiku i mëposhtëm e ilustron këtë gjetje.



Grafiku nr.7: Marrëdhënia mes gjendjes ekonomike, nivelit arsimor dhe akuzës për kryerjen e një veprë penale

Sikurse u pohua edhe më sipër, vetëperceptimi për nivelin e të ardhurave ekonomike, sidomos në kontekstin shqiptar, përbën një të dhënë e cila duhet marrë në konsideratë me rezerva, sepse shpesh herë ajo çfarë të miturit dhe të rinjtë mund të raportojnë në një anketë, dhe asaj çfarë ndodh realisht në familjet e tyre, mund të mos jenë në përputhje me njëra-tjetrën. Përvoja tregon se statusi ekonomik i familjes ndikon drejtpërdrejt me pozicionimin shoqëror të të miturve dhe të rinjve dhe në kushtet e jetesës në institucione të mbyllura; kjo përcakton dhe një lloj hierarkie sociale të anëtarëve të këtij grupi.

4.1.1.3. Recidivistët

Recidivistët janë një grupim relativisht i vogël brenda targetit të përgjithshëm të të anketuarve në këtë studim, por pesha e tyre specifike brenda grupimit të të rinjve, që janë nën akuzë ose janë dënuar, nuk është e vogël (34 nga 148 ose 32.9 për qind). Ajo që vihet re është se në qytet kemi përqindjen më të lartë të recidivistëve. Për afro 55.8 për qind (19 të mitur dhe të rinj nga 34) kanë raportuar se jetojnë në qytet, 20.5 për qind e recidivistëve (7 të mitur dhe të rinj nga 34) raportojnë se jetojnë nëpër zona të etiketuara si periferike, ndërsa në fshat kjo përqindje është vetëm 17.6 për qind (6 të mitur dhe të rinj nga 34).

Këto raporte na tregojnë se rreziku për të rënë në sjellje devjante në mënyrë të përsëritur është më i madh në qytet, ku edhe lidhjet familjare dhe ndikimi i grupit të ngushtë shoqëror nisin e dobësohen, por edhe mundësitë për t'u integruar në bashkësi mund të jenë të kufizuara.

Marrëdhënia mes nivelit të edukimit dhe përsëritjes së veprës penale duket e drejtpërdrejtë. Në tërësinë e të anketuarve recidivistë, 10 prej tyre janë me arsim fillor, 16 me arsim të mesëm dhe 4 pa arsim (ndërsa 4 veta nuk kanë raportuar asnjë të dhënë për këtë çështje).

4.1.1.4. Përfshirja në programet e drejtësisë restauruese

Sikurse u theksua në fillim të këtij nën-kreu, një nga objektivat e studimit është të shqyrtohet sesi profili social e familjar i të miturve dhe të rinjve, që janë përfshirë në konflikte ose janë të prirur

për t'u përfshirë në to, ndikon në shkallën e njohjes dhe të përfshirjes në programet e drejtësisë restauruese.

Pyetjes se a kishin dëgjuar ndonjëherë për drejtësinë restauruese, 652 të anketuar i janë përgjigjur pozitivisht, por vetëm 28.4 për qind e përgjigjedhënësve, që kanë informacion për drejtësinë restauruese (185 nga 652), janë përfshirë dhe kanë përfituar nga ky program. Rreth 44.8 për qind e të miturve dhe të rinjve që kanë përfituar nga program i drejtësisë restauruese janë vajza (83 nga 185), ndërsa rreth 54 për qind janë djem (100 nga 185). Rreth 61.6 për qind e të rinjve dhe të miturve që kanë përfituar nga program i drejtësisë restauruese janë nga qyteti (114 të anketuar nga 185), 17.8 për qind janë nga fshati (33 të anketuar nga 185) dhe 18.3 për qind e atyre që kanë përfituar nga program i drejtësisë restauruese kanë raportuar se janë nga zona periferike (34 të anketuar nga 185). Një përqindje e vogël e përgjigjedhënësve nuk e kanë plotësuar rubrikën e vendbanimit.

Duhet theksuar se programi i drejtësisë restauruese, përveçse trajtim është dhe një program edukues. Për këtë arsye, një pjesë e rëndësishme e projektit të sipërpërmendur shtrihet në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qyteteve të sipërpërmendura, me qëllim që drejtësia restauruese dhe parimet e saj të përvetësohen nga të miturit dhe të rinjtë nëpërmjet veprimtarive ekstrakurrikulare që në bankat e shkollës dhe të bëhen udhëzuese në krijimin e marrëdhënieve njerëzore sa më konstruktive. Kështu, nga gjetjet vihet re se rreth 64.3 për qind e atyre që kanë përfituar nga programi i drejtësisë restauruese, pohojnë se kanë arsim 9-vjeçar (119 të anketuar nga 185) dhe rreth 22.7 për qind pohojnë se kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe / ose janë në ndjekje të vitit të parë të studimeve universitare (42 të anketuar nga 185). Por interesant është fakti që vetëm 12.9 për qind pohojnë se janë pa arsim ose kanë përfunduar vetëm arsimin fillor (24 të anketuar nga 185). Kjo kategori ka përfituar nga programi i drejtësisë restauruese më së shumti duke i zgjidhur drejtpërdrejt konfliktet e tyre me anë të procesit të ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës ose takimit në grup.

Rreth 17.2 për qind e të miturve dhe të rinjve, që kanë pohuar se kanë përfituar nga program i drejtësisë restauruese (32 të anketuar nga 185), kanë raportuar se kanë të ardhura të pakta familjare, nuk kanë fare të ardhura ose janë të varfër. Rreth 70.2 për qind kanë pohuar se kanë të ardhura mesatare mujore (130 të anketuar nga 185), ndërsa vetëm 8.6 për qind e tyre kanë pohuar se kanë të ardhura mujore familjare shumë të mira (16 të anketuar nga 185). (Rreth 4 për qind e përgjigjedhënësve nuk e kanë plotësuar këtë rubrikë).

Këto gjetje nuk tregojnë ndonjë domethënie të veçantë për marrëdhënien e nivelit të të ardhurave familjare dhe shkallës së përfshirjes në programet e drejtësisë restauruese. Këto programe ofrohen për të gjitha kategoritë sociale, por shpesh kanë në fokus shtresat e margjinalizuara shoqërore, të mitur dhe të rinj që jetojnë në varfëri, që kanë ndërprerë shkollën, që vijnë nga bashkësi të stigmatizuara shoqërore etj., por pavarësisht nga kjo, vetëperceptimi i të anketuarve, në lidhje me të ardhurat familjare, nuk e nxori në pah këtë. Përdorimi i burimeve të tjera për përfitim të të dhënave, siç janë intervistat e thëlluara me ekspertë të fushës që merren me trajtimin e të miturve dhe të rinjve në kontakt me ligjin, mund të hedhë më shumë dritë për këtë marrëdhënie.


Interesant paraqitet fakti se ndër të miturit dhe të rinjtë që janë në proces gjykimi dhe akuzohen për kryerjen e ndonjë kundërvajtjeje penale, 59.5 për qind (88 të mitur dhe të rinj nga 148) kanë informacion për ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese dhe 25 për qind (37 të mitur dhe të rinj nga 148) kanë pohuar se kanë përfituar nga ky program. Duke qenë se me këtë kategori të miturish dhe të rinjsh, procesi i anketimit u krye *face to face* dhe jo me vetëraportim, për shkak të vështirësive që ka kjo kategori në procesin e të lexuarit, u vu re se procesi bashkëkohor i ndërmjetësimit ngatërrohej me atë tradicional, megjithatë duhet përmendur që pothuaj të gjithë këta të mitur dhe të rinj kanë qenë target i projektit në fjalë.

4.1.2. Informacioni dhe perceptimi për drejtësinë restauruese. Krahasimi i perceptimeve mes kategorive sociale të bashkësisë rome, të mitur dhe të rinj në paraburgim dhe të rinj në shkolla

Ky seksion kishte si synim të mblidhte informacion për mënyrat si i zgjidhin situatat konfliktuale pjesëmarrësit në studim, cilën rrugë zgjedhin ata, ç'informacion kanë për ndërmjetësimin, si dhe perceptimin e tyre për rëndësinë e drejtësisë restauruese. Të dhënat e përfuara nga anketimi gjithashtu janë analizuar sipas 3 kategorive të përgjigjedhënësve: anëtarëve nga bashkësia rome, të miturit dhe të rinjtë në paraburgim dhe të miturit dhe të rinjtë në shkolla. Në këtë mënyrë, ky kre i përgjigjet objektivit të dytë të studimit, të paraqitur në pjesën hyrëse të tij.

Tri kategoritë e sipërpërmendura janë pjesë e programeve të drejtësisë restauruese, trajtojnë nevoja sa të ngjashme, aq edhe të ndryshme dhe, për rrjedhojë, perceptimet e tyre paraqesin interes të veçantë në këtë studim.

Pyetjes “Nëse përhiheni në një situatë konfliktuese ose kundërvajtje penale, si do të reagoni?” Pjesa më e madhe e përgjigjedhënësve, 54.9 për qind (569 të anketuar), i janë përgjigjur se do të parapëlqenin që t'i drejtoheshin rrugës ligjore. Grafiku i mëposhtëm paraqet të shprehura në përqindje përgjigjet e të anketuarve.



Grafiku nr.8: Reagimi kundrejt një suate konfliktuese ose kundërvajtje penale

Interesant paraqitet fakti se këtë alternativë e kanë përkrahur më shumë nxënësit në shkolla (66.1 për qind e të anketuarve në shkolla ose 492 të anketuar), më pak të miturit dhe të rinjtë në paraburgim (19.4 për qind e të anketuarve në paraburgim ose 25 të anketuar), të cilët kanë zgjedhur më së shumti alternativën “do ta falnim/do ta harronim” (29.5 për qind ose 38 të anketuar) dhe ata nga bashkësia rome, të cilët kanë zgjedhur më së shumti alternativën “Do t’i drejtoheshim një pale profesioniste dhe të paanshme jashtë sistemit gjyqësor”(31.9 për qind e të anketuarve nga kjo bashkësi ose 29 të anketuar). Duke qenë se mjaft të mitur dhe të rinj nga bashkësia rome, që janë përfshirë në studim, janë përfshirë drejtpërdrejt në programin e drejtësisë restauruese në kuadër të projektit “Zhvillimi institucional i Drejtësisë Restauruese dhe Ndërmjetësimit Viktimë-Kundërvajtës për të Miturit në Shqipëri”, duket se ata e njohin dhe e vlerësojnë këtë si një alternativë të rëndësishme për zgjidhjen e konflikteve të tyre. Njohja dhe përfshirja në këtë program, i ka bërë ata të jenë më të ndërgjegjësuar për efektivitetin e alternativave të drejtësisë restauruese, të krahasuar me përfshirjen e tyre në procesin gjyqësor. Sigurisht që nëse në procesin e anketimit do të merrnin pjesë anëtarë të bashkësisë rome, të cilët nuk janë të përfshirë më parë në programet e drejtësisë restauruese, rezultatet e studimit mund të ishin të ndryshme. Në këtë rast studimi nuk pati synim përgjithësimin e gjetjeve për të gjithë anëtarët e bashkësisë rome, por evidentimin e qëndrimit që të miturit dhe të rinjtë nga kjo bashkësi mbajnë në lidhje me rëndësinë e zbatimit të programi të drejtësisë restauruese.

	Bashkë- sia rome	Paraburgim	Shkolla
T’i drejtoheshit një pale të tretë profesioniste dhe të paanshme jashtë sistemit gjyqësor	31,9	17,8	10,6
Ta zgjidhnit çështjen me anë të familjes/shokëve/ të afërmve	30,8	22,5	11,6
Ta falnit/harronit	17,6	29,5	9,4
T’i drejtoheshit rrugës ligjore	13,2	19,4	66,1
Pa përgjigje	3,3	3,9	0,0
Ta shtynit për më vonë vetëgjyqësinë/hakmarrjen	3,3	9,9	18,7
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr. 4: Rrugët për të zgjidhur një situatë konfliktuese


Përgjithësisht të anketuarit zgjedhin mënyrën e mësipërme, sepse mendojnë se kjo është mënyra më e mirë për të zgjidhur çështjen e tyre. Pyetjes “Cila është arsyeja kryesore pse shikoni me përparësi këtë alternativë të zgjidhjes së çështjes suaj?”, të miturit dhe të rinjtë, që morën pjesë në këtë studim, i janë përgjigjur në përqindje sipas kategorive të mëposhtme:

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkol- la
Sepse keni më shumë besim te kjo rrugëzgjidhje	38,4	27,6	28,7
Sepse çështja zgjidhet më mirë	41,9	56,9	63,0
Sepse çështja zgjidhet pa shpenzime financiare	9,3	4,9	2,3
Sepse çështja zgjidhet më shpejt	10,5	10,6	5,9
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr. 5: Arsyeja e përparësisë për zgjedhjen e alternativës për të zgjidhur konfliktin

Për të tria kategoritë e të miturve vihet re se zgjidhja e mirë (me cilësi) e çështjes së tyre të konfliktit ka rëndësi parësore. 41.9 për qind e të anketuarve nga bashkësi rome (ose 36 të anketuar), 56.9 për qind e të anketuarve nga sistemi i paraburgimit dhe dënimit me heqje lirie (ose 70 të anketuar) dhe 63 për qind e të anketuarve nga shkollat (ose 458 të anketuar) kanë raportuar se kanë zgjedhur zgjidhjen e mësipërme, sepse kanë besim se në atë mënyrë çështja zgjidhet më mirë.

Sikurse u paraqit edhe më sipër, pyetjes “A keni dëgjuar ndonjëherë për zgjidhje të mundshme jashtë rrugës gjyqësore si ndërmjetësimin viktimë-kundërvajtës, dialogun ose drejtësinë restauruese?”, 64.2 për qind e të anketuarve i janë përgjigjur pozitivisht (652 të anketuar) dhe 35.8 për qind i janë përgjigjur negativisht. Kjo përqindje reflekton grupin e fokusuar të anketimit, sepse ata që morën pjesë në procesin e anketimit janë kryesisht të përfshirë më parë në programet e drejtësisë restauruese, por kjo nuk do të thotë se shkalla e ndërgjegjësimit për rëndësinë e zbatimit të drejtësisë restauruese është e lartë edhe për popullatën e gjerë. Pra, për këtë çështje, studimi, gjithashtu, nuk synoi të bëjë përgjithësime.




Grafiku nr.9: Informacioni për ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese

Nëse shohim të dhënat e ndara sipas 3 kategorive të sipërpërmendura, vihet re se në secilën kategori pjesa më e madhe e përgjigjedhënesve (mbi 60 për qind për secilën kategori: 55 të mitur dhe të rinj nga bashkësia rome, 85 të mitur dhe të rinj në paraburgim dhe të dënuar dhe 491 të mitur dhe të rinj në shkolla) kanë pohuar se kanë informacion për zgjidhjen jashtëgjyqësore të konflikteve.

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Po	61,8	61,6	64,9
Jo	38,2	38,4	35,1
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.6: Informacioni për ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese sipas kategorive të të miturve dhe të rinjve

Duke u fokusuar te kategoria e të anketuarve që janë përgjigjur se kanë informacion për zgjidhjen jashtëgjyqësore të konflikteve, u synua të merrej informacion, për rrugët nga e kanë përftuar këtë informacion. Kështu pyetjes se “Nga e keni marrë informacionin?”, 53.2 për qind e të anketuarve (305 të anketuar) i janë përgjigjur “nga media”, 29.7 për qind (170 të anketuar) kanë zgjedhur alternativën nga të njohur, fqinj e miq, 13.3 për qind (76 të anketuar) kanë pohuar se këtë informacion e kanë marrë nga ndërmjetësit dhe 3.8 për qind (22 të anketuar) kanë pohuar se këtë informacion e kanë marrë nga punonjësit e policisë. Megjithëse kjo e fundit është një shifër modeste, ajo është domethënëse dhe shpreh bashkëpunimin e institucionit të policisë me shërbimin e ndërmjetësit, në funksion të zgjidhjes paqësore të konflikteve.




Grafiku nr.10: Burimi i informimit për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin

Ndarja sipas 3 kategorive, na tregon se të miturit dhe të rinjtë nëpër shkolla kanë marrë informacion për këtë çështje nga media, ndërsa të miturit dhe të rinjtë në paraburgim kanë marrë informacion për ndërmjetësimin nga miq e të njohur. Megjithëse të miturit dhe të rinjtë nga bashkësia rome kanë pohuar se janë informuar më së shumti nga media (41.2 për qind), si dhe nga miqtë e të njohurit (31.4 për qind), përvoja empirike tregon se shkalla e informimit të bashkësisë rome nëpërmjet medias është shumë e ulët. Vetë procesi i anketimit mbart në vetvete riskun e përgjigjeve jo plotësisht të sinqerta të të anketuarve, kështu që kjo e dhënë duhet marrë parasysh për t'u hulumtuar në mënyrë të kujdesshme nga studime të mëtejshme. Domethënëse është përqindja e të anketuarve që kanë marrë informacion për ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese nga ndërmjetësit. Vihet re një përqindje më e lartë e raportuar nga të miturit dhe të rinjtë në paraburgim dhe të dënuar (25.7 për qind ose 19 të anketuar) atje ku ndikimi i programit të drejtësisë restauruese dhe shërbimi i ndërmjetësimit është ofruar në shumë plane (trajnim, edukim, zgjidhje konfliktesh), një përqindje më e ulët e raportuar nga anëtarët e bashkësisë rome (19.6 për qind ose 10 të anketuar) dhe më pak akoma e raportuar nga të miturit dhe të rinjtë në shkolla (10.5 për qind ose 47 të anketuar).

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Nga ndërmjetës	19,6	25,7	10,5
Nga të njohur, fqinj, miq	31,4	51,4	25,9
Nga media	41,2	16,2	60,7
Nga punonjës policie	7,8	6,8	2,9
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.7: Burimi i informimit për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin sipas kategorive të të miturve dhe të rinjve

Pyetjes nëse kanë përfituar nga ky shërbim, e cila iu drejtua të miturve që kishin informim për shërbimin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë restauruese, pjesa më e madhe e të anketuarve (71.6 për qind) i janë përgjigjur negativisht.



Grafiku nr.11: Përfitimi nga programi i drejtësisë restauruese

Më sipër në rubrikën “Përfshirja në programet e drejtësisë restauruese” u bë një paraqitje disi e detajuar e profilit social dhe familjar të të miturve dhe të rinjve të anketuar që kanë pohuar se janë përfshirë në këto programe, profil ky që lidhet me gjininë, vendbanimin, nivelin arsimor dhe nivelin e të ardhurave familjare të të anketuarve.

Sikurse vihet re edhe në tabelën e mëposhtme, pjesa më e madhe e të miturve, që janë përgjigjur se kanë përfituar nga shërbimi i ndërmjetësimit dhe programi i drejtësisë restauruese, janë anëtarë të bashkësisë rome (40 për qind e të anketuarve nga bashkësia rome ose 24 të anketuar) dhe të mitur dhe të rinj në paraburgim dhe të dënuar (35.1 për qind e të miturve dhe të rinjve në paraburgim dhe të dënuar ose 34 të anketuar), kategori të cilat, përveç të tjerash, kanë qenë në vëmendje të programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit.

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Po	40,0	35,1	23,1
Jo	60,0	64,9	76,9
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.8: Përfitimi nga programi i drejtësisë restauruese sipas kategorive


Ndërsa pyetjes se “A ka përfituar ndonjë i afërmi juaj nga ky shërbim?”, e cila sërish iu drejtua të miturve që kishin informacion për shërbimin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë

restauruese, pjesa më e madhe e të anketuarve i është përgjigjur “Nuk e di” (40 për qind e të anketuarve nga bashkësia rome ose 34 të anketuar, 32,8 për qind e të anketuarve në paraburgim dhe të dënuar ose 39 të anketuar dhe 54.9 për qind e të anketuarve nga shkollat ose 372 të anketuar). Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e të anketuarve i është përgjigjur negativisht pyetjes së mësipërme, duke pohuar që të afërmit e tyre nuk kanë përfituar nga shërbimi i ndërmjetësimit (47.1 për qind e të anketuarve nga bashkësia rome ose 40 të anketuar, e njëjta përqindje e të anketuarve në paraburgim dhe të dënuar ose 56 të anketuar dhe 32.6 për qind e të anketuarve nga shkollat ose 221 të anketuar). Kjo shpjegohet edhe me faktin që lidhja mes të afërmeve është zbehur në shoqërinë shqiptare dhe informimi jo gjithmonë qarkullon mes tyre, qoftë kjo edhe për çështje me një rëndësi të veçantë, siç është zgjidhja e konflikteve.

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Po	12,9	20,2	12,4
Jo	47,1	47,1	32,6
Nuk e di	40,0	32,8	54,9
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.9: Informimi për përfitimin e të afërmeve nga drejtësia restauruese

Të miturve, të cilët në seksionin II të këtij pyetësori (pyetja 14) janë përgjigjur se janë përfshirë në konflikt, u është drejtuar pyetja 26: “A e konsiderojnë të zgjidhur konfliktin në të cilin janë përfshirë” Qëllimi i kësaj pyetjeje ishte evidentimi i një prirjeje nga ana e të miturve dhe të rinjve të përfshirë në studim, për t’i zgjidhur ose jo konfliktet, pavarësisht nga rruga që zgjedhin për t’i zgjidhur ato. U vu re se pjesa më e madhe e të anketuarve (65.9 për qind) e konsiderojnë të zgjidhur konfliktin në të cilin kanë raportuar se janë përfshirë. Grafiku i mëposhtëm paraqet pikërisht këtë qëndrim të të anketuarve.



Grafiku nr.12: Konsiderata për zgjidhjen e konfliktit

Duke u mbështetur në ndarjen sipas kategorive, vihet re se të miturit dhe të rinjtë nga bashkësia rome dhe nga kategoria në paraburgim e kanë lënë pa përgjigje pyetjen: “A e konsideroni të zgjidhur konfliktin në të cilin jeni përfshirë”? (37.4 për qind nga bashkësia rome ose 34 të anketuar dhe 28.1 për qind nga të anketurit në paraburgim ose 39 të anketuar). Ndërsa të anketuarit në shkolla i janë përgjigjur kësaj pyetjeje me “po” ose “jo” ku mbizotëron përgjigjja pozitive me 69.5 për qind (ose 386 të anketuar). Sikurse vihet re, kategoria e të miturve dhe të rinjve nga bashkësia rome dhe paraburgimi shprehin një lloj ngurrimi për t’iu përgjigjur pyetjeve për situatat konfliktuale në të cilat ata përfshihen.

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Po	54,9	58,3	69,5
Jo	7,7	13,7	30,5
Pa përgjigje	37,4	28,1	0,0
Shuma (%)	100	100	100


Tabela nr.10: Konsiderata për zgjidhjen e konfliktit sipas kategorive

Të anketuarve që janë përgjigjur se e kanë zgjidhur konfliktin në të cilin janë përfshirë, u është adresuar pyetja: “A keni komunikuar me palën që keni qenë të konfliktuar, pasi e keni zgjidhur konfliktin me mirëkuptim?” Pjesa më e madhe e të anketuarve nga bashkësia rome i janë përgjigjur pozitivisht (92.6 për qind ose 50 të anketuar) dhe nga të anketuarit në shkolla, gjithashtu (73.4 për qind ose 348 të anketuar), por mbetet domethënëse në një farë mënyre kategoria e të miturve dhe të rinjve në sistemin e paraburgimit dhe të dënuarit, të cilët shprehen se, megjithëse e kanë zgjidhur konfliktin, nuk komunikojnë me palën tjetër (31.4 për qind ose 27 të anketuar).

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Po	92,6	68,6	73,4
Jo	7,4	31,4	26,6
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.11: Komunikimi me palën e konfliktuar

Më pas, të anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e mësipërme u është kërkuar të përshkruajë se sa herë janë takuar me palën tjetër dhe nga përgjigjet vihet re se pjesa më e madhe e të anketuarve kanë dhënë përgjigjen “kur na bie rasti” (46.5 për qind e të anketuarve ose 257 të anketuar).



Grafiku nr.13: Shpeshësia e komunikimit me palën e konfliktuar

Përgjigjen “kur na bie rasti” e gjejmë në frekuenca më të larta te kategoria e të miturve dhe të rinjve nga bashkësia rome (45.3 për qind ose 24 të anketuar) dhe te të miturit dhe të rinjtë në shkolla (48.4 për qind ose 210 të anketuar). Kategoria e të miturve dhe të rinjve nga sistemi i paraburgimit dhe i të dënuarve ka raportuar me frekuenca më të larta se komunikon “rrallë” me palën e konfliktuar (37.9 për qind ose 25 të anketuar).

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Shpesh	39,6	27,3	16,4
Kur na bie rasti	45,3	34,8	48,4
Rrallë	15,1	37,9	35,3
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.12: Shpeshësia e komunikimit me palën e konfliktuar sipas kategorive

Në lidhje me pyetjen se “*kush mendoni se është personi më i përshtatshëm që ju ndihmon në zgjidhjen e një konflikti?*”, të miturit e përfshirë në studim, kanë pohuar se tri burimet kryesore janë: një anëtar i familjes (47.2 për qind ose 435 të anketuar), një ndërmjetës profesionist, i paanshëm (18.9 për qind ose 174 të anketuar), një shok (14.2 për qind ose 131 të anketuar). Një e dhënë e tillë është domethënëse, pasi nxjerr një prirje të të miturve dhe të rinjve, sidomos atyre që kanë qenë pjesë e programit të ndërmjetësimit dhe të drejtësisë restauruese për t’i besuar këtij programi.

Të dhënat e ndara sipas tri kategorive të të anketuarve, nxorën në pah se të miturit dhe të rinjtë në paraburgim e të dënuar (48.5 për qind ose 63 të anketuar) si dhe ata në shkollë (49.5 për qind ose 347 të anketuar) mendojnë se një anëtar i familjes përbën njeriun më të përshtatshëm për t’i ndihmuar ata në rast konflikti, ndërsa të anketuarit nga bashkësia rome në një pjesë të madhe të rasteve (33.7 për qind ose 30 të anketuar), i besojnë një ndërmjetësi profesionist dhe të paanshëm, por sigurisht edhe për ta një anëtar i familjes (28.1 për qind ose 25 të anketuar) dhe një shok (22.5 për qind ose

20 të anketuar) mbeten alternativa të përshtatshme. Me sa duket për këtë kategori të anketuarish, të cilët kanë qenë dhe janë pjesë e programit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, është krijuar në një farë mase një besueshmëri kundrejt ndërmjetësit si profesionist i paanshëm.

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Një punonjës policie	3,4	4,6	4,7
Një shok	22,5	25,4	11,1
Një anëtar i familjes	28,1	48,5	49,5
Një mësues	3,4	3,1	1,6
Një ndërmjetës profesionist i paanshëm	33,7	13,1	18,1
Psikologu	3,4	3,1	4,0
Një avokat	2,2	1,5	8,3
Punonjësi social	3,4	0,8	2,7
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.13: Burimi më i përshtatshëm i ndihmës në rast konflikti, sipas kategorive të të miturve dhe të rinjve

Të dhënat e anketimit nxorën gjithashtu në pah se pavarësisht nëse kanë përfituar ose jo nga këto programe, të miturit dhe të rinjtë e anketuar (rreth 85 për qind ose 840 të anketuar) janë të gatshëm të pranonin procesin e zgjidhjes së konfliktit përmes ndërmjetësimit dhe të përfshiheshin në programin e drejtësisë restauruese për zgjidhjen e konflikteve të tyre. Pyetja: “A do ishit i gatshëm të pranonit procesin e zgjidhjes së konfliktit përmes ndërmjetësimit dhe të përfshiheshit në programin e drejtësisë restauruese për zgjidhjen e konflikteve tuaja?” ka marrë në një pjesë të madhe të rasteve përgjigje pozitive nga të tri kategoritë e të anketuarve. Të dhënat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

	Rom	Paraburgim	Shkolla
Po	92,0	84,1	84,8
Jo	8,0	15,9	15,2
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.14: Pranimi i programit të drejtësisë restauruese


Gjithashtu, një pjesë po kaq e rëndësishme e pjesëmarrësve në procesin e anketimit (87 për qind ose 856 të anketuar) ka pohuar se do të ishin të gatshëm t'ia rekomandonin shërbimin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë restauruese miqve dhe të afërmeve të tyre.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten frekuencat për të tri kategoritë e të anketuarve. Sikurse vihet re, të anketuarit nga bashkësia rome kanë përqindje më të larta pohuese (93.3 për qind e të miturve dhe të rinjve romë që i janë përgjigjur kësaj pyetjeje ose 83 të anketuar) në krahasim me kategoritë e tjera. Pyetja: “A do ishit i gatshëm t’ia rekomandonit shërbimin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë restauruese miqve dhe të afërmeve tuaj?” merr këto përgjigje:

	Bashkësia rome	Paraburgim	Shkolla
Po	93,3	79,7	87,6
Jo	6,7	20,3	12,4
Shuma (%)	100	100	100

Tabela nr.15: Rekomandimi i programit të drejtësisë restauruese për të tjerët

Pyetja e fundit në pyetësor synoi të merrte të dhëna për perceptimin e të anketuarve për frytshmërinë e procesit të ndërmjetësimit dhe programit të drejtësisë restauruese. Pyetjes: “A mendoni se po të ishit përfshirë më parë në procesin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë restauruese, do të kishit shmangur kryerjen e kundërvajtjes penale?”, e cila iu drejtua atyre që ishin përfshirë në konflikte dhe/ose kishin kryer kundërvajtje penale, pjesa më e madhe e të anketuarve (52.7 për qind ose 512 të anketuar) janë përgjigjur “nuk e di”. Ky profil përgjigjeje vihet re te të tri kategoritë e të anketuarve (Grafiku më poshtë).



Grafiku nr.14: Ndërgjegjësimi për efektet parandaluese të drejtësisë restauruese

Kjo tregon për një shkallë të ulët të ndërgjegjësimit të të miturve dhe të rinjve për efektet pozitive parandaluese të dialogut restaurues, në uljen e mundësisë për t'u përfshirë në konflikte dhe kundërvajtje penale dhe shmangien e recidivizmit, çka mbetet një sfidë për t'u kapërcyer.

4.2. Analiza e të dhënave cilësore

4.2.1. Të dhëna të përftuara nga intervistat

4.2.1.1. Efekti i drejtësisë restauruese te të miturit e përfshirë në sistemin penitenciar

Ky nënkre synon të analizojë perceptimin e profesionistëve të fushës mbi impaktin e shërbimit të ndërmjetësimit dhe të drejtësisë restauruese në shmangien e fëmijëve dhe të rinjve nga sistemi penitenciar, si dhe zbatimin e kësaj drejtësie që ndikon në uljen e shkallës së konfliktualitetit dhe të recidivizmit.

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se një pjesë e të intervistuarve kanë dëgjuar për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin. Ata kanë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara gjatë zbatimit të projektit, duke u angazhuar si lehtësues, mbështetës dhe partnerë në ofrimin e programit të drejtësisë restauruese.

Ka dhe një pjesë profesionistësh të rinj që nuk kanë informacion dhe e konsiderojnë me interes rritjen e informacionit në këtë fushë.

Të intervistuarit raportojnë se drejtësia restauruese krijon mundësinë që të arrihet një ekuilibër mes nevojave të viktimës, autorit dhe bashkësisë, duke i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e drejtësisë sa më shumë që të jetë e mundur të gjitha palët.

“Është shumë e rëndësishme që ndërmjetësi të jetë një person i kualifikuar, profesionist dhe me zotësitë dhe cilësitë e duhura për ta ofruar shërbimin e ndërmjetësimit” (Punonjësi i sektorit të edukimit, Korçë).

Të intervistuarit raportojnë se është i nevojshëm harmonizimi i legjislacionit penal, në mënyrë që praktika restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit në kontakt me ligjin të bëhet funksional dhe i zbatueshëm.

Inspektorët e policisë shprehin shqetësimin se ka një hendek në procedurën e referimit të rasteve për ndërmjetësim.

“Kur unë referoj një rast për ndërmjetësim, çduhet të bëj me të? A duhet t’ia kaloj prokurorisë, ndërkohë që palët marrin shërbimin e ndërmjetësimit, apo të pres përgjigjen nga ndërmjetësi për ecurinë e rastit? Është në përgjegjësinë time, nëse ndonjë palë ankohet pse çështja nuk ka kaluar në prokurori dhe nëse çështja shkon në prokurori dhe gjykatë atëherë palët shkojnë drejt drejtësisë penale. Mendoj se duhet përmirësuar legjislacioni në favor të drejtësisë restauruese” (Inspektor i policisë së qarkut, Durrës).

Punonjësit e sektorit të edukimit në I.E.V.P. japin idenë se duhet përmirësuar legjislacioni në mënyrë që aktmarrëveshja e pajtimit të ndikojë drejtpërdrejt në lehtësimin e dënimit të të miturit. Shumë nga të miturit që kanë konflikte me palë jashtë institucionit janë të interesuar për të përfituar ulje dënimi, nëse mes tyre dhe viktimës arrihet të nënshkruhet aktmarrëveshje pajtimi.

Në disa raste nga të intervistuarit raportohet si një formë e rëndësishme procesi i ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës, i cili u ofron viktimave një mundësi për të takuar shkelësit në një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe të angazhohen në një diskutim të ndërmjetësuar. Angazhimi i palëve për një qëllim të përbashkët e bën më të lehtë gjetjen e një zgjidhje që kënaq të dyja palët.

Me ndihmën e një ndërmjetësi profesionist, viktimat është në gjendje t'i tregojë shkelësit pasojat fizike, emocionale dhe dëmin financiar, duke krijuar mundësinë që të përfshihet në zhvillimin e një plani për kthimin dhe pagimin e dëmeve financiare për viktimën.

Ndërmjetësimi shikohet me interes pasi do të ndihmonte shumë edhe realitetin shqiptar nisur nga konteksti, kultura, mendësia dhe shkalla e konfliktualitetit. Ekspertët e intervistuar e konsiderojnë ndërmjetësimin si një formë ndërhyrjeje që trajtojnë problemin dhe që shmang përshkallëzimin e konflikteve të mëtejshme.

Të intervistuarit vlerësojnë se programet e drejtësisë restauruese zvogëlojnë edhe mundësinë e recidivizmit të të miturit, duke qenë se krijojnë mundësinë që i mituri të mos e shikojë vuajtjen e dënimit si ndëshkim, por të përfitojë nga sanksione dhe masa që kanë ndikim edukues. Drejtësia restauruese bazohet në pajtim e jo në ndëshkim, bazohet te pranimi i përgjegjësive nga ana e kundërvajtësit për sjelljen e tij dhe të përfshirja e viktimës në negocimin e marrëveshjes.

Përgjatë procesit të intervistimit specialistët e edukimit në sektorët e paraburgimit në I.E.V.P-ve, raportuan barrierat që kanë të rinjtë për të kuptuar rezultatet pozitive të veprimtarive që kanë si qëllim zhdëmtimin ose ndryshimin e sjelljes. Këto barrierat lidhen me nivelin e ulët të edukimit të fëmijëve dhe me mjediset e varfëra familjare nga të cilat vijnë të miturit. Ata sugjerojnë se ndërhyrjet restauruese kanë ndikimin më të madh kur të rinjtë janë në gjendje të përjetojnë rezultatet e veprimeve të tyre: *“Të mësojnë nga përvoja”*. Ata përmendën si të rëndësishme ndarjen e përvojave. Ata, gjithashtu, theksuan nevojën për programet restauruese që krijojnë mundësinë që i mituri të përjetojë emocione që ndodhin si pasojë e veprimeve të tyre.

Në përgjithësi nga të intervistuarit raportohet se drejtësia restauruese është një alternativë e domosdoshme që mund të përdoret nga familjet e të miturve. Ka shumë raste që konfliktet me palët e tjera nuk duan t'i zgjidhin për punë krenarie tradicionale ose ndikim të fisit etj. Shpesh janë problematika shumë të vogla që mund të zgjidhen shumë më shpejt me anë të ndërmjetësimit dhe të mos përshkallëzohen në forma edhe më të rënda.

“Të dërgosh një të mitur në prokurori ose polici është një ngarkesë psikologjike për të miturin, shkakton edhe stres familjar. I mituri duhet trajtuar në një mënyrë tjetër dhe jo të burgoset menjëherë. Burgimi duhet të jetë alternativa e fundit”(Punonjës i Shërbimit të Provës, Lezhë).

Sipas të intervistuarve, burgosja është dhe një nga alternativat më të rënda për të miturin dhe që nuk krijon gjithmonë atë efekt që pritet. Kjo është edhe një nga masat që krijon paragjykime dhe sjell diskriminim, përjashtim për të miturin edhe kur ai kërkon që të ndryshojë dhe të integrohet në shoqëri.

“Personi vodhi disa sende në një market dhe, si pasojë, ai u kap dhe u dënua me 2 vjet heqje lirie. Pasi kreu dënimin ai aplikoi për një vend punë si kuzhinier. Gjykata refuzonte t'i jepte atij një

vërtetim që tregonte se nuk kishte një proces të hapur gjyqësor dhe kishte mbaruar dënimin dhe vetëm kishte detyrim paraqitjeje te shërbimi i provës” (Punonjës i Shërbimit të Provës, Lezhë).

Edhe shkolla konsiderohet një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e procesit të ndërmjetësimit, duke qenë se kjo alternativë rrit mundësitë e parandalimit të konflikteve, të përshkallëzimit të konfliktit që çon në dhunë dhe për rrjedhojë në vepra kriminale. Të intervistuarit raportojnë disa raste, ku shkollat kanë kërkuar mbështetjen nga persona të trajnuar të programit për të zgjidhur konfliktet, pa e pasur të nevojshme që t’i referojnë raste të tilla në polici. Ndërmjetësimi me bazë shkollën, duke përdorur një qasje të ekuilibruar përmes drejtësisë restauruese, u mundëson nxënësve të marrin përgjegjësi për sjelljet e tyre në shkollë.

Gjatë procesit të intervistimit raportohet, gjithashtu, nevoja e pjesëmarrjes së bashkësisë në ndërhyrjet restauruese dhe theksohet se, aktualisht, përfshirja e bashkësisë mungon në shumicën e rasteve. Ka një prirje drejt zhvillimit të ndjenjave individualiste në bashkësi, duke bërë që njerëzit të përqendrohen në thelbin e problemit të vet. Bashkësitë në të cilat njerëzit mbajnë një qëndrim individualist nuk mund të vlerësojnë rolin që ato luajnë në mbështetjen e të rinjve për krijimin e personalitetit dhe identitetit të tyre dhe për t’u mundësuar atyre për të ndaluar kryerjen e krimit. Ndërgjegjësimi i bashkësisë vlerësohet tepër i domosdoshëm.

Në përgjithësi perceptimi dhe opinioni i specialistëve të intervistuar mbështet domosdoshmërinë e harmonizimit të legjislacionit penal, në mënyrë që praktika restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit në kontakt me ligjin të bëhet funksional ose i zbatueshëm.

4.2.1.2. Njohja e faktorëve që lidhen me recidivizmin, parakusht për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese

Njohja e faktorëve të riskut dhe faktorëve të mbrojtjes është e rëndësishme për të kuptuar kriminalitetin dhe recidivizmin të të miturit. Kjo njohje ndihmon në fokusimin e ndërhyrjeve efektive për parandalimin ose uljen e recidivizmit tek individë ose grupe që përballen me këta faktorë. Identifikimi dhe kuptimi i faktorëve të mbrojtjes ndihmon në planifikimin dhe hartimin e ndërhyrjeve që zhvillojnë potencialet e individit për të ndërprerë ose parandaluar përfshirjen në krim.

Në këtë linjë argumentimi, specialistët e intervistuar shprehen se njohja e faktorëve, që lidhen me recidivizmin, konsiderohet një parakusht shumë i rëndësishëm për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese të kategorisë së miturve dhe të rinjve recidivistë.

Specialistët e intervistuar raportojnë se veprat penale, në të cilat përfshihen më së shumti të miturit, janë vjedhje, kanosje, armëmbajtje pa leje, fyerje nëpërmjet rrjeteve sociale, bullizëm, drejtim automjeti pa leje, trafikim lëndësh narkotike, plagosje të lehtë, plagosje të rëndë, ndonjë rast edhe për vrasje në bashkëpunim ose më vete.

Studimet e ndryshme kanë zbuluar se ka një numër faktorësh të sferës individuale, familjare, shkollore dhe komunitare që ndikojnë në mundësinë që i mituri të bëhet recidivist (Chung dhe Steinberg, 2006; Frederick, 1999; Katsiyannis dhe Archwamety, 1997).

Të intervistuarit raportojnë se karakteristikat demografike si: gjinia, mosha, raca dhe etnia janë të lidhura me nivelin e recidivizmit. Faktorët familjarë, bashkëmoshatarë dhe shkollorë janë të njohur si faktorë ndikues në recidivizëm, po ashtu dhe abuzimi me substancat dhe problemet e shëndetit mendor të patrajuara. Problemet familjare të tilla si divorce, papunësia, konfliktet familjare sjellin recidivizmin dhe mungesën e vëmendjes për të miturin, duke e bërë shumë të vështirë periudhën e gjykimit dhe dënimit të mundshëm.

Sipas specialistëve të intervistuar motivimi i ulët, rezultate të dobëta në shkollë, niveli i lartë i braktisjes së shkollës dhe kushtet e këqija fizike të shkollës janë faktorë risku. Nga studimi raportohet se recidivistët janë ata që dënohen kryesisht për vjedhje dhe vepra penale të përsëritura. Si shkaqe kryesore përmenden kushtet e vështira të jetesës, mungesa e edukimit të vazhdueshëm, neglizhimi prindëror, si dhe shoqërimi me bashkëmoshatarë devijantë.

“Gjendja ekonomike ndikon, papunësia e prindërve. 90 për qind e recidivistëve vijnë nga kjo kategori. I mituri kur nuk ka kushte, nuk ka mundësi, kur nuk i plotësohen nevojat, p.sh. veshja ose disa nevoja të tjera që lindin nga jeta me bashkëmoshatarët... “detyrohet” në një farë mënyre të kryej devijancë” (Punonjës i sektorit të edukimit, Kavajë).

Një grup tjetër karakteristikash, që lidhen me recidivizmin, janë ato që kanë të bëjnë me mjedisin ku i mituri qëndron. Studimet tregojnë se bashkësitë e çorganizuar në aspektin social nuk kanë mjete informale të kontrollit social dhe në këtë mënyrë rritet krimi dhe kriminaliteti. Edhe sipas të dhënave të mbledhura, mundësia e recidivizmit dhe lloji i veprës që një i mitur do të kryejë, varet shumë nga bashkësia ku do të jetojë i mituri pas lirimimit. Prania dhe shoqërimi në bashkësi me bashkëmoshatarë, që janë të përfshirë në sjellje të rrezikshme, rrit shanset e recidivizmit të të miturit.

“Ka dhe nga ata të mitur që vijnë për herë të tretë për qejf. Është mburrje për ta” (Punonjës i sektorit të edukimit, Kavajë).

4.2.1.3. Rëndësia e njohjes së faktorëve mbrojtës të brendshëm të të miturve për zbatimin e drejtësisë restauruese të të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin

Identifikimi i faktorëve mbrojtës së të miturve ndihmon që të zbatohet më lehtë drejtësia restauruese, duke qenë se identifikohen të gjitha burimet brenda dhe jashtë individit që ndihmojnë në trajtimin e problemit. Këta faktorë mbrojtës konsiderohen të rëndësishëm për ndërtimin e rrugës së zhvillimit që ndihmon të miturit dhe të rinjtë të rriten të shëndetshëm, të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm. Sa më shumë asete të kenë të rinjtë, aq më shumë ka të ngjarë që ata të zgjedhin një stil jetese të shëndetshme, të marrin vendime më pak të rrezikshme dhe të jenë anëtarë produktivë të bashkësisë. Disa nga faktorët mbrojtës, të identifikuar dhe të raportuar nga të intervistuarit, janë si më poshtë:

- **Motivimi për arritje të mira në shkollë.** Të intervistuarit e shohin shkollën si një institucion shumë të rëndësishëm për uljen e rasteve të përfshirjes së fëmijëve në kontakt me ligjin dhe

për ndryshimin, që mund të sjellë së bashku me institucionet e tjera në jetën e të miturit. Prindërit në përgjithësi janë arsimdashës dhe duan që fëmijët të vazhdojnë shkollën. Kjo lidhet edhe me sigurinë më të madhe që edukimi krijon për punësimin e të rinjve.

“Arsimi luan rol në uljen e numrit të rasteve të fëmijëve të përfshirë në kontakt me ligjin dhe rrjedhimisht dhe në uljen e recidivizmit. Ne vëmë re që recidivistët kanë një nivel të ulët arsimor. Maksimumi kanë 4-5 klasë shkollë. (Punonjës i sektorit të edukimit, Kavajë).

Search Institute ka përmbledhur faktorët mbrojtës të brendshëm si më poshtë:

- **Ndershmëria.** Është një tregues që i mituri kërkon që të reflektojë dhe të kërkojë mbështetjen e profesionistëve. Sipas profesionistëve të miturit përpiqen të identifikojnë dhe kuptojnë drejtë situatën në të cilën ndodhen.
- **Përgjegjshmëria, pranon dhe merr përgjegjshmëri vetjake.** I mituri analizon situatën dhe pranon se ku ka gabuar dhe kjo i ndihmon profesionistët që të punojnë më lehtë me të miturin.
- **Aftësi ndër-vetjake.** Ka të mitur që shfaqin empati dhe kërkojnë që të krijojnë kontakte me punonjësit e edukimit, por edhe me bashkëmoshatarë.
- **Aftësi për të zgjidhur konflikte.** Të miturit, që identifikojnë forma jo të dhunshme të menaxhimit të konflikteve, tregojnë për një faktor individual shumë të rëndësishëm që mund t'i mbajë larg situatave të rrezikshme.
- **Vështrim pozitiv për të ardhmen.** Kjo lidhet shumë me atë se çfarë e pret të miturin pasi ka vuajtur dënimin dhe mbështetjen që i ofrohet për të rritur vetëvlerësimin e tij. Janë specialistët ata që duhet të drejtojnë të miturin tek identifikimi i burimeve individuale.

4.2.1.4. Rëndësia e njohjes së faktorëve mbrojtës të jashtëm për zbatimin e drejtësisë restauruese te të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin

Të intervistuarit raportojnë se faktorët mbrojtës të jashtëm lidhen edhe me një element të rëndësishëm që ka të bëjë me përfshirjen e bashkësisë dhe të aktorëve të tjerë të jashtëm që krijojnë një terren të përshtatshëm për zbatimin e drejtësisë restauruese. Faktorët mbrojtës të jashtëm krijojnë mundësinë që të miturit të rrisin kompetencat dhe të përfitojnë një ndjenjë përkatësie. Përfshirja e bashkësisë krijon lidhjet në bashkësi, të cilat mund të ofrojnë mbështetje për të miturit që mund të vazhdojë pasi ata të largohen nga sistemi.

- **Komunikim pozitiv në familje dhe mbështetja që ofron familja.** Të intervistuarit raportojnë se ka prindër që interesohen shumë, por ka dhe prindër që për shkak të largësisë, varfërisë dhe arsyeve të tjera nuk shfaqin interes dhe nuk ndihmojnë në procesin e rehabilitimit, edukimit të fëmijës.

“Kemi pasur ndonjë rast tek-tuk kur për shkak të krenarisë prindërit, kryesisht baballarët, nuk interesoheshin për fëmijën se ia kishin nxirë faqen. Për ne është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi,

por jo gjithmonë e kemi këtë mundësi” (Punonjës i sektorit të edukimit, Kavajë).

Bashkëpunimi me familjen është shumë i rëndësishëm, sepse familja është ajo që e ndjek dhe kontrollon sjelljen dhe veprimet në të cilat përfshihet i mituri. Familja vendos kufijtë dhe drejton të gjithë procesin e rritjes dhe të zhvillimit të të miturit. Në disa raste familja bën vetëm një adresim sipërfaqësor të problemit, mjaftohet që parandalon shkallën e lartë të rrezikut dhe nuk merret me trajtimin e problemit të fëmija.

- **Bashkësia e kujdesshme, mbështetëse** ndihmon që i mituri të integrohet më lehtë dhe më shpejt pas vuajtjes së dënimit. Në përgjithësi raportohet se bashkësia ofron një klimë diskriminuese, paragjyquese dhe jo mbështetëse për të miturit dhe familjet e tyre.

“Rasti i Albanit, kemi dashur ta punësojmë në biznes dhe askush nuk e pranonte. Mungojnë shërbimet mbështetëse për të miturit që dalin nga burgu” (Specialist i sektorit të edukimit, Drenovë, Korçë).

- **Shërbim ndaj të tjerëve.** Puna në bashkësi është një nga alternativat që ofron shërbimi i provës për të miturit. Në përgjithësi raportohet nga të intervistuarit, që dënimet alternative duhet të jenë një nga format që përdoret më shumë me të miturit. Dënimet alternative duhet të shoqërohen edhe me programe edukuese për ndryshimin e sjelljes dhe qëndrimeve të të miturve.

Search Institute ka përmbledhur faktorët e mbrojtjes së jashtëm si më poshtë, të cilët janë faktorë që përmenden edhe nga të intervistuarit:

- **Klimë pozitive në shkollë.** Siç edhe raportohet nga të intervistuarit, shkolla është një nga institucionet që ka një ndikim të rëndësishëm në sjelljen dhe formimin e të rriturit jo vetëm në planin e edukimit, por në tërësinë e formimit. Sa më shumë të jetë i angazhuar i mituri në procesin arsimor, aq më pak ka gjasa të përfshihet në sjellje të rrezikshme /devijante.
- **Siguria ekonomike, sociale.** Varfëria, papunësia, problemet e familjes janë të gjitha faktorë që krijojnë pasiguri dhe jostabilitet në rritjen dhe zhvillimin e të miturit.

“Punësimi ul recidivizmin. Të miturit kanë pak interes për t’u punësuar qoftë edhe me orë. “Ç’të bëj unë me 100 mijë lekë!- thonë.” Kështu gjejnë rrugën më të shkurtër, vjedhjen” (Punonjës i sektorit të edukimit, Kavajë).

- **Kufijtë në familje, kontrolli dhe mbështetja që ofron për të miturin**

Të intervistuarit raportojnë që ka edhe familje që nuk interesohen për fëmijët, nuk kanë besim që mund të ndryshojnë sjelljen e fëmijës dhe e lënë në dorë të institucioneve.

“Kemi një të mitur në këtu, ai thotë unë sa të dal pas 7 ditësh këtu më keni prapë se s’kam ku të shkoj. “Familja e tij nuk do t’ia dijë” (Punonjës i sektorit të sigurisë, Kavajë.)

- **Ndikim pozitiv nga bashkëmoshatarët.** Bashkëmoshatarët sjellin një ndikim shumë të madh në jetën e të miturve. Përfshirja në grupe bashkëmoshatarësh, që janë të përfshirë në sjellje të rrezikshme, rrisin shkallën e rrezikut edhe për të miturin.

4.2.1.5. Ndërhyrjet që ndikojnë në uljen e recidivizmit te të miturit. Drejtësia restauruese, një mënyrë frytshme

Studimet më të fundit tregojnë se drejtësia restauruese ka qenë efektive në trajtimin e recidivizmit (Hayes dhe Daly, 2003; Maxwell dhe Morris, 2001; Sherman, Strang dhe Woods, 2000). Mes këtyre studimeve është dhe një studim meta-analizë e 35 programeve të drejtësisë restauruese që tregojnë se këto programe ishin më efektive se programet korrektuese tradicionale të mbikëqyrjes në reduktimin e recidivizmit (Latimer, Dowden, dhe Muijs, 2005).

Sipas të dhënave të mbledhura, raportohet që recidivizmi mund të ulet nëse i kushtohet vëmendje e veçantë të miturve kur mbarojnë dënimin ose paraburgimin. Duhet krijuar kushte të përshtatshme jetese për të miturit që jetojnë në kushte të vështira financiare, për ata që nuk jetojnë në familje të rregullta ose kanë problematika të ndryshme.

Studimet tregojnë se burgimi i fëmijëve ose zbatimi i masave shtrënguese, si vendosja në institucione riedukimi, është një proces shumë i dhimbshëm për çdo fëmijë, i cili dëmton zhvillimin e fëmijës dhe jep efektin e kundërt për socializimin e tij. Specialistët e intervistuar raportojnë se modelet e mbështetjes për fëmijën duhet të ofrohen në bashkëpunim me familjen. Fuqizimi i familjes është një element shumë i rëndësishëm për gjithë procesin e mbështetjes në vazhdim, që duhet të ofrohet për të miturit recidivistë. Gjithashtu, në përgjithësi është pranuar që mohimi i lirisë rrallëherë është një masë efektive për sa i përket rehabilitimit, riintegrimin dhe parandalimit të shkeljeve të mëtejshme. Nga ana tjetër studimet në këtë fushë sugjerojnë se adoleshentët kanë më shumë mundësi për t'u rehabilituar se të rriturit, sepse personaliteti i tyre vazhdon të krijohet, ndërsa truri i tyre vazhdon të ndryshojë.

“Kemi vëne re një fenomen, një pjesë e madhe e të miturve që sillen këtu për pak ditë mund të ndodhë që këta të mitur të mund t'i shohin këto ambjente si vend ku mund të rikthehen përsëri” (Punonjës i paraburgimit, Vlorë).

Drejtësia për të miturit përfshin shumë çështje të tilla si: parandalimin e kriminalitetit, zbatimin e ligjit, gjykimin dhe rehabilitimin nëpërmjet formave të ndryshme, si ndërmjetësimi, drejtësia restauruese etj. Administrimi i drejtësisë për të miturit është një fushë që kërkon kombinimin e politikave penale dhe politikave sociale, me qëllim mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve.

Masa të tilla si: respektimi i të drejtave; mbrojtja nga abuzimi dhe shfrytëzimi; arsimimi; kujdesi shëndetësor; një mirëqenie fizike, mendore dhe sociale ndihmojnë në mbajtjen e fëmijëve larg përfshirjes në krime dhe janë thelbësore në trajtimin e fëmijëve që hyjnë në kontakt me ligjin.

Ndërhyrja e duhur për të miturit që janë përfshirë për herë të parë në një vepër penale është shmangia nga sistemi i drejtësisë penale dhe mbështetja nga programe rehabilituese, riparuese, ndërsa më shumë vëmendje duhet drejtuar te të miturit recidivist.

“Legjislacioni duhet të jetë më i favorshëm, më i butë lidhur me dënimin e të miturve”. (Punonjës policie, Shkodër).

Kombinimi i politikave penale me politikat e tjera në fushën e arsimimit, të mbështetjes dhe fuqizimit të familjes, të shëndetit mendor, të aftësisë profesionale dhe punësimit të rinjve shihen si ndërhyrjet më të përshtatshme dhe efektive për uljen e recidivizmit të miturit. Pjesa më e madhe e të intervistuarve raportojnë një mungesë të shërbimeve kur të miturit përfundojnë vuajtjen e dënimit dhe dalin nga institucioni.

“Kur del minoreni shoqërohet nga një specialist dhe mund të ndodhë që gjërat kanë ndryshuar kur ata rikthen në familje. Në një nga rastet kur fëmijën e shoqëruam në familje ai pa njerkun kur shkoi në shtëpi dhe nuk donte të qëndronte” (Specialist i Edukimit, Drenovë, Korçë).

Sipas të dhënave të mbledhura në disa institucione të vuajtjes së dënimit ofrohen shërbime të ndryshme si edukimi i të miturve, kurse të gjuhës së huaj, kurse pune me dru, hidraulike, punë edukative, veprimtari të ndryshme sportive, terapi arti etj.

Disa nga institucionet, të cilat ofrojnë shërbime për të miturit janë OJF të ndryshme si Meridia, Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara, Shoqata “Përthyerje”, organizata fetare, etj.

Nevoja për mbështetje dhe bashkëpunim me institucione të ndryshme është shumë e madhe, sepse ka raste kur fëmijët nuk kanë mbështetje familjare, u mungon kontakti me prindërit dhe kur ikin nga institucioni i rehabilitimit/vuajtjes së dënimit, nuk dihet se ku shkojnë.

“Një i mitur tjetër nga Rrogozhina që e kemi këtu na thotë: “Ç’do bëj unë tek kazanët e plehrave?”. Dhe në fakt këtu i mituri u shëndosh, ndryshoi. Kjo kategori të miturish ndjen ankth në momentin që i vjen koha për të dalë. Ku do shkojnë, ku do përplasen”? (Punonjës i sektorit të sigurisë, Kavajë).

Punonjësit e shërbimit të provës raportojnë disa vështirësi gjatë punës me të miturit. Shumë nga rastet që ata kanë trajtuar kanë vështirësi ekonomike, janë larg dhe nuk mund ta sjellin fëmijën sa herë që i kërkohet nga shërbimi i provës. Puna me të miturit është më e vështirë, pasi nuk vijnë që të paraqiten. Të miturit duhet të shoqërohen nga prindërit/kujdestarët.

Informacioni, që punonjësit e shërbimit të provës mbledhin për familjen e të miturit, është shumë sipërfaqësor dhe kjo vjen si rezultat i numrit shumë të madh të rasteve me të cilat ata duhet të punojnë dhe numrit shumë të vogël të stafit. Këta punonjës hartojnë sistemet e rrezikshmërisë së fëmijës dhe planin individual të trajtimit, por nuk ka një ndjekje të veçantë për të miturit. Të miturit nuk kanë akses në shërbimet për shkak të largësisë dhe mungesës së shërbimeve në qytetet ku ata banojnë.

“Qendra e Formimit Profesional është vetëm në Elbasan, ndërkohë që në qytete të tjera nuk ka. Të miturit që janë nga qytetet e tjera nuk kanë mundësi të ndjekin kurset në Elbasan për shkak të vështirësive ekonomike” (Punonjës i Shërbimit të Provës, Elbasan).

Shërbimi i Provës në Shkodër zbaton një program të veçantë për të miturit. Prej 2 muajsh në marrëveshje me organizata joqeveritare realizohen fokus grupe për sensibilizimin dhe informimin e të miturve dhe prindërve, seanca individuale këshillimi dhe mbështetjeje që të shmanget kryerja e veprës penale. Shërbimi i Provës bashkëpunon me Qarkun dhe Bashkinë e Shkodrës, me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve për trajtimin e rasteve konkrete të të miturve, si edhe me Drejtorinë Arsimore.

Kanë tentuar që të kenë bashkëpunim me bizneset për integrimin në tregun e punës të të miturve që kanë përfunduar dënimin, por kanë vështirësi për shkak të paragjykit, të bazuar në veprat penale që kanë kryer të miturit.

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve në nivel bashkie/komune është një mekanizëm shumë i rëndësishëm që mund të ndihmojë të miturin për një integrim më të mirë në shoqëri pas vuajtjes së dënimit, si dhe familjen për fuqizimin e saj në shërbim të të miturit. Nga të dhënat e mbledhura në pjesën më të madhe të rasteve nuk raportohen bashkëpunime me këtë shërbim.

Raportohet nga specialistët e intervistuar një nivel i ulët bashkëpunimi dhe angazhimi i aktorëve të ndryshëm për trajtimin e nevojave të të miturve. Në zinxhirin e shërbimeve, që ofrohen për të miturit, jo të gjithë ofruesit e shërbimeve japin kontributin e duhur për trajtimin e nevojave të të miturve. Sistemet e referimit nuk funksionojnë ose ofruesit e shërbimeve jo gjithmonë kanë informacion se ku mund të shkojë një i mitur për të marrë një shërbim.

Sikurse u theksua në fillim të këtij studimi, sistemi i drejtësisë restauruese ndihmon në përmbushjen e disa nevojave kryesore të të miturve dhe të rinjve, autorë të veprave penale, ndër të cilat më e rëndësishmja është inkurajimi në jetën në bashkësi. Në këtë këndvështrim ofrimi i ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës dhe i programit të drejtësisë restauruese në përgjithësi duhet të përbëjnë një hallkë të rëndësishme bashkëpunuese me të gjitha hallkat e tjera ofruese të shërbimit të të miturve dhe të rinjve në kontakt me ligjin.

4.2.2. Raste studimore të zgjidhjes së konflikteve sipas programit të drejtësisë restauruese

Ky kre ka si qëllim që të ilustrojë në mënyrë konkrete zgjidhjen e disa rasteve të konflikteve nëpërmjet ndërmjetësimit, duke iu përmbajtur parimeve të drejtësisë restauruese, duke u vënë në funksion të arritjes së objektivit të tretë të parashtruar në hyrjen e këtij studimi.

Rastet janë zgjedhur në mënyrë të qëllimshme nga tërësia e rasteve të zgjidhura me ndërmjetësim në kuadrin e projektit “Zhvillimi institucional i drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës për të miturit në Shqipëri”. Në këto raste të paktën njëra palë e përfshirë është në moshën 14-21 vjeç.

Rastet e mëposhtme janë referuar nga burime të ndryshme dhe përmbajnë çështje konfliktuale të natyrave të ndryshme. Është bërë një përzgjedhje e tillë për të dëshmuar që ndërmjetësimi dhe drejtësia restauruese kanë një rreze të gjerë veprimi dhe, nëpërmjet teknikave konkrete, depërtojnë në marrëdhëniet njerëzore, duke i transformuar ato në marrëdhënie konstruktive.

Rasti i parë është referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Durrësit dhe ka si subjekt konfliktin e ndodhur në një shkollë të mesme të përgjithshme publike. Rasti i dytë është referuar nga bashkësia rome në Shkodër dhe pasqyron një konflikt mes dy të rinjve nga kjo bashkësi, ndërsa rasti i tretë është referuar nga Instituti i Ekzekutimit të Veprave Penale në Vlorë dhe pasqyron një konflikt mes dy të miturve në sektorin e paraburgimit.

Në të tria rastet është zbatuar drejtësia restauruese, e cila nëpërmjet ndërmjetësimit ka mundësuar jo vetëm zgjidhjen e situatës konfliktuese, por edhe përmirësimin e marrëdhënies mes palëve të përfshirë në konflikt. Në këtë kontekst drejtësia restauruese, përveç se një instrument trajtimi konkret i konflikteve, është dhe një proces edukimi që synon të kultivojë tek anëtarët e shoqërisë ndjenjën e faljes dhe të tolerancës, të mirëkuptimit dhe të pajtimit, të ulë tensionet e të rrisë ndjenjën e empatisë dhe të pranimit të tjetrit, duke kontribuar kështu në krijimin e një shoqërie paqedashëse dhe të emancipuar.

Rasti 1

Përmbledhje e konfliktit

Palët në konflikt janë dy adoleshentë, një vajzë 16 vjeç dhe një djalë 17 vjeç, nxënës të një gjimnazi në Durrës. Edhe pse nxënës në të njëjtën shkollë, palët nuk njiheshin nga afër me njëri-tjetrin dhe nuk kishin pasur asnjë kontakt shoqëror ndërmjet tyre. Djali e njihnte vajzën nga larg dhe si shoqen e disa vajzave që banonin afër shtëpisë së tij. Vajza nga ana e saj nuk e njihnte aspak djalin, madje as si nxënës të shkollës ku ajo studioje. E gjithë ngjarja konfliktuale ka nisur kur djali i shkruante vajzës mesazhe në rrjetin social Facebook. Si fillim mesazhet përmbanin kërkesën nga ana e djalit për miqësi, jo me vajzën në fjalë, por me një mikeshë të ngushtë të saj. Vajza i ishte përgjigjur mesazheve, duke i thënë se nuk i interesonin këto biseda dhe nuk donte të merrte mesazhe nga një i panjohur për të. Djali ka këmbëngulur përsëri, duke e kërcënuar vajzën se në qoftë se nuk i kthente përgjigje mesazheve të tij, ai do të hakmerrej. Vajza për të mos marrë më mesazhe prej tij, nëpërmjet një opsioni në këtë rrjet social e “bllokoi” kontaktin me të. Pas disa ditësh merr vesh nga shoqet e klasës që në një rrjet tjetër në internet ishte hedhur një video me fotografi të vajzës në fjalë, ku në secilën prej fotografive kishte etiketuar fyese dhe tepër të rënda për imazhin e saj si adoleshente dhe si vajzë. Vajza, në çastin që merr vesh këtë gjë, e fyer dhe e turpëruar, vendosi të mos shkojë në shkollë për disa ditë. Gjatë këtyre ditëve në familje kishte shfaqur shenja të forta të shqetësimit të saj. Pas një jave të mosfrekuentimit të shkollës, vajza vendosi të rikthehej përsëri në shkollë, por gjatë një ore mësimi, një nga mësueset e klasës e pyet në prani të gjithë shokëve të klasës se çfarë ishte ajo video që qarkullonte në emër të saj (të vajzës). Në këtë çast lajmi për këtë ndodhi përhapet edhe më shumë dhe merret vesh edhe nga ata shokë që nuk e dinin. Vajza e rënduar akoma më shumë psikologjikisht, e referon çështjen në komisariat dhe policisë.

Punonjësi i policisë kontakton prindërit e nxënësve, dhe me pëlqimin e tyre e referon rastin për ndërmjetësim.

Seanca paraprake

Ndërmjetësja, pasi mori letrën e referencës nga policia, kontaktoi fillimisht palën e parë, babanë e vajzës dhe vajzën. Pala pranoi pa hezitim të linte takim me këtë ndërmjetëse. Ky takim

u bë në shkollën ku të rinjtë studionin, në mjediset e drejtorisë së shkollës dhe në praninë e drejtoreshës së shkollës dhe psikologes, me pëlqimin e palës. Gjatë këtij takimi vajza tregoi me hollësi të gjithë situatën konfliktuale. Vajza, gjithashtu, shprehu se nuk ishte e fyer vetëm nga djali që realizoi këtë video, por edhe nga mësuesja që nuk ishte treguar e matur dhe e kishte pyetur vajzën në atë lloj forme. Duke vlerësuar rastin, ndërmjetësja vendosi ta trajtonte situatën konfliktuale në dy plane: Konflikti mes vajzës dhe djalit, si dhe plani i dytë, mosmarrëveshja mes saj dhe mësueses. Ndërmjetësja kontaktoi mësuesen dhe la një takim me të. Gjatë takimit mësuesja tregoi ngjarjen dhe pranoi se ishte treguar e pamatur dhe pa dashje e kishte shqetësuar vajzën.

Pastaj ndërmjetësja la një takim dhe me djalin dhe babanë e tij. Babai i djalit në fjalë u paraqit bashkë me të birin në zyrën e ndërmjetësimit dhe iu bë me dije qëllimi i këtij procesi. Babai u tregua shumë bashkëpunues me ndërmjetësen. Gjatë seancës djali tregoi ngjarjen dhe shprehu keqardhje për situatën e krijuar.

Seanca e përbashkët e ndërmjetësimit

Në takimin e përbashkët me vajzën, prindin e saj dhe mësuesen, morën pjesë dhe drejtoresha e shkollës dhe psikologja, kështu që ndërmjetësimi u zhvillua në formën e një “konference në bashkësi”. Mësuesja pranoi përgjegjësinë e saj dhe premtoi që do të tregohej më e matur në komunikimin me vajzën dhe nxënësit në përgjithësi.

Pastaj ndërmjetësja kontaktoi sërish prindin e djalit të përfshirë në konflikt dhe la një takim të përbashkët me të dhe palën tjetër (vajzën dhe prindin e saj). Vajza u paraqit me të ëmën në procesin e përbashkët të ndërmjetësimit, në të cilën ishte, gjithashtu, e pranishme dhe mësuesja e përfshirë në konflikt. Vlen për t'u theksuar se babai dhe djali nuk shprehen as një lloj hezitimi për t'i kërkuar falje vajzës dhe i premtuan vajzës se nuk do të kishte asnjë lloj shqetësimi në të ardhmen nga ana e djalit. Palët, përfshirë këtu edhe mësuesen, e nënshkruan pa ngurruar marrëveshjen. Babai i djalit u shpreh se ndërmjetësimi ishte tepër i vlefshëm, sepse ai nuk po gjente guximin për t'iu drejtuar familjes së vajzës dhe për t'i kërkuar falje vajzës, sepse nuk dinte se si do reagonte familja e saj. Ai, gjithashtu, shprehu se ndihej i lehtësuar moralisht nga kjo ngjarje.

Pas ndërmjetësimit

Është praktikë që pas çdo zgjidhjeje konflikti, ndërmjetësi të kontaktojë dhe të realizojë takim me palët, për të parë se si shkon marrëdhënia mes tyre, nëse është zbatuar aktmarrëveshja etj. Ndërmjetësi kontaktoi pas 2 javësh me palët dhe ata u takuan në një nga lokalet pranë shkollës. Marrëdhënia mes tyre ishte stabilizuar, ata ishin pajtuar dhe ishin të kënaqur nga procesi i ndërmjetësimit.

Rasti 2

Përmbledhje e konfliktit

A, 16 vjeç (Pala I) dhe B 17 vjeç (Pala II) janë fqinjë. Ata janë shokë, por pas mësimit punojnë bashkë për të mbledhur hekurishte. Një ditë, pasi mblodhën hekurishte A dhe B vunë re se A kishte mbledhur më shumë hekurishte se B, prandaj filluan të debatonin për çështjen e lekëve që siguronin nga shitja e tyre. Zakonisht të ardhurat nga kjo punë i ndanin bashkërisht, por atë ditë diferenca mes hekurishteve të mbledhura nga secili ishte disi më e madhe. Në fillim palët debatuan me fjalë. Pala I e shau duke e ofenduar palën II dhe më pas e qëllloi atë. I nevrikosur, ky i fundit, rrëmbeu një copë hekuri nga hekurishtet e mbledhura dhe e goditi në sup palën I, duke i shkaktuar një plagë. Disa djem të lagjes aty pranë, ndërhyrën t'i qetësonin palët dhe më pas komunikuan me përfaqësuesin e bashkësisë rome, i cili bashkëpunon me zyrën e ndërmjetësimit. Pasi i njohu palët në vija të përgjithshme me ndërmjetësimin dhe mori pëlqimin e tyre, përfaqësuesi i bashkësisë rome ia referoi rastin zyrës së ndërmjetësimit.

Seanca paraprake

Ndërmjetësi kontaktoi prindërit e palës së parë dhe la një takim me ta dhe djalin, të njohur si pala I. Në takim u paraqit babai i djalit A bashkë me djalin. Djali A shpjegoi variantin e tij të konfliktit mes tij dhe palës tjetër. Babi i djalit ishte tepër i shqetësuar për situatën e krijuar, jo vetëm sepse pala II, sipas tij kishte punuar më pak dhe ngrinte një pretendim të pabazuar për të marrë një sasi të barabartë parash me djalin e tij, i cili kishte punuar më shumë, por ishte akoma më shumë i shqetësuar për dhunën që pala II kishte ushtruar kundrejt palës I. Ndërmjetësi mbante shënime të detajuara dhe në fund të seancës përgatiti një raport përmbledhës për këtë takim dhe çfarë u diskutua në të. Takimi zgjati rreth 80 minuta dhe u zhvillua në një mjedis të qetë dhe miqësor. Më pas ndërmjetësi kontaktoi dhe prindërit e palës së dytë dhe la dhe me ta një orar takimi. Takimi me palën B dhe babanë e tij u zhvillua, gjithashtu, në një mjedis të qetë dhe të përshtatshëm për ndërmjetësim. Pala e dytë shpjegoi variantin e tij të ngjarjes dhe kërkonte që si gjithmonë të përdorej logjika e ndarjes së parave nga shitja e hekurishteve në mënyrë të barabartë për të dy palët, pa vënë re se kush kishte sjellë më shumë hekurishte sepse, nëse njëra palë sot sillte më shumë, tjetra mund të sillte më shumë nesër. Ndërsa për dhunën fizike të ushtruar kundrejt palës I, pala II shprehej e penduar, por kërkonte që dhe pala I të kërkonte falje për ofendimin dhe qëllimin me shuplakë që kishte bërë kundrejt palës II. Edhe për këtë takim ndërmjetësi mbajti një raport të veçantë. Ky takim zgjati rreth 90 minuta.

Pasi u realizuan këto takime të veçanta paraprake, ndërmjetësi ftoi palët në një takim të përbashkët.

Seanca e përbashkët e ndërmjetësimit

Seanca e përbashkët e ndërmjetësimit u realizua në një mjedis të qetë dhe miqësor. Të dy djemtë ishin të shoqëruar nga prindërit e tyre. Ndërmjetësi u shpjegoi palëve rregullat, të cilave palët duhet t'u përmbaheshin gjatë këtij takimi të përbashkët. Palët u përpoqën të ruanin gjakftohtësinë dhe e dëgjonin me kujdes njëri-tjetrin pa ndërhyrë.

Palët ranë dakord që paratë për sasinë e hekurishteve të shitura t'i kompensoheshin palës së parë në shitjen e ardhshme dhe mes tyre të vendosej një rregull i ri: "Paratë të ndaheshin në varësi të sasisë së hekurishteve që çdo i mitur arrinte të siguronte". Gjithashtu, pala e parë i kërkoi falje palës së dytë për fyerjen e shkaktuar nëpërmjet sharjes dhe pala e dytë i kërkoi falje palës së parë për goditjen dhe plagën e shkaktuar, por dhe pala e parë i kërkoi falje palës së dytë për dhunën verbale dhe fizike që kishte përdorur kundrejt tij. Palët premtuan se sjellje të tilla nuk do të përsëriteshin më mes tyre.

Pas ndërmjetësimi

Ndërmjetësi kontaktoi pas 10 ditësh me palët dhe ata u takuan në një nga lokalet pranë zonës ku të rinjtë banonin. Marrëdhënia mes tyre ishte stabilizuar, ata ishin pajtuar dhe ishin të kënaqur nga procesi i ndërmjetësimit. Për këtë palët plotësuan edhe një pyetësor që synon matjen e kënaqësisë së palëve nga procesi i ndërmjetësimit.

Rasti 3

Përmbledhje e konfliktit

D, 18 vjeç (pala I) dhe F, 17 vjeç (pala II) janë dy djem që ndodhen në sektorin e paraburgimit në një nga institucionet e ekzekutimit të veprave penale në Shqipëri. Konflikti mes palëve ka lindur në palestër, ku të miturit bëjnë stërvitje sipas programit të miratuar nga I.E.V.P. Pala e dytë ka ardhur prej disa muajsh në këtë I.E.V.P. dhe, megjithëse është i ri në këtë mjedis, paraqet problematika në komunikim me të miturit e tjerë. Duke mos i njohur rregullat e funksionimit të raporteve me të miturit në I.E.V.P, ai është konfliktuar me fjalë me njërin prej të miturve, i cili po përdorte njërin prej veglave të palestrës, duke i drejtuar atij fjalë fyese me qëllim që pala e parë t'ia linte atë ta përdorte. Pala e parë iu kundërpërgjigj, gjithashtu, me shprehje fyese. Në këto kushte pala e dytë është revoltuar dhe ka tentuar ta tërhiqte palën e parë nga vegla, por pa dashje e ka goditur atë me krah në stomak. Pas këtij veprimi, jo vetëm që nuk i ka kërkuar falje palës së parë, por ka vazhduar ta fyejë. Ky veprim ka nxitur menjëherë reagimin e palës së parë, i cili është recidivist dhe ka shumë kohë në institucion. Pala e parë, me një fizik shumë të zhvilluar, e ka tërhequr vullshëm palën e dytë dhe e ka goditur me grushta dhe shqelma, duke i shkaktuar atij dëmtime. Ndërhyrja e rojave të sigurisë bëri të mundur ndalimin e këtij veprimi dhe rasti, me pëlqimin e palëve, iu referua zyrës së ndërmjetësimit.

Seanca paraprake

Ndërmjetësja e caktuar për të ofruar shërbimin e ndërmjetësimit realizoi takime të veçanta me secilën nga palët. Në të dyja takimet, të cilët u zhvilluan në mjediset e I.E.V.P.-së, ishte i pranishëm edhe përgjegjësi i sektorit të shërbimit social, i cili e kishte referuar rastin te shërbimi i ndërmjetësimit.

Gjatë takimit me palën e parë u zhvillua në një atmosferë të qetë dhe zgjati rreth 40 minuta. Pala e parë tregoi variantin e vetë të ngjarjes. Ai pohoi se në këtë konflikt ishte përfshirë rastësisht, por sjellja e palës së dytë ishte provokuese, çka, sipas tij, e kishte detyruar të reagonte në atë formë.

Pala e dytë, në takimin e veçantë me ndërmjetësin, pretendonte se nuk kishte bërë asgjë të qëllimshme, por rastësisht, për shkak të nervozizmit, kishte reaguar në atë mënyrë. Kjo palë e kishte shumë të vështirë ta falte palën e parë, sepse ende kishte dhimbje nga dhuna fizike që pala e parë kishte ushtruar kundrejt tij. Ky takim zgjati rreth 35 minuta.

Më pas palët u ftuan në takimin e përbashkët.

Seanca e përbashkët e ndërmjetësimit

Seanca e përbashkët e ndërmjetësimit u realizua në një mjedis normal, të qetë dhe miqësor në ambientet e I.E.V.P.-së. Rregullat e këtij takimi ishin të njohura për të dyja palët, por ndërmjetësi ua kujtoi edhe një herë ato. Pala e parë mori nismën për dhënien e alternativës së zgjidhjes të konfliktit, duke kërkuar ndjesë për dhunën e ushtruar ndaj palës së dytë, por njëkohësisht kërkoi prej kësaj pale mospërsëritjen e veprimeve provokuese. Reagimi i palës së dytë ishte impulsiv dhe shfaqte pasiguri, por në përgjithësi procesi shkoi normalisht. Pala e dytë e fali palën e parë dhe premtoi se sjelljet provokuese nuk do të përsëriteshin më kundrejt palës së parë. Të dyja palët komunikuan normalisht, duke premtuar moskonfliktimin në të ardhmen. Në përfundim të dyja palët pranuan me vullnetin e tyre të lirë të nënshkruanin aktmarrëveshjen e pajtimit. Ky takim zgjati rreth 50 minuta.

Pas ndërmjetësimit

Ndërmjetësi kontaktoi pas 14 ditësh me përgjegjësin e sektorit të shërbimit social në I.E.V.P.-në, ku kishte ndodhur konflikti dhe i kërkoi informacion për marrëdhënien mes palëve. Përgjegjësi i sektorit të shërbimit social pohoi se marrëdhënia mes të rinjve ishte stabilizuar, ata ishin pajtuar dhe ishin të kënaqur nga procesi i ndërmjetësimit. Të rinjtë marrin pjesë normalisht në veprimtari të përbashkëta në I.E.V.P. dhe frekuentojnë mjediset e përbashkëta, duke mos shfaqur asnjë problem kundrejt njëri-tjetrit.

5. PËRFUNDIME

Në mënyrë të përmbledhur ky studim nxori në pah disa përfundime. Nga rezultatet e *anketimit*, doli në pah se:

- » Pothuaj shumica e të miturve dhe të rinjve të anketuar përfshihen në konflikte të ndryshme sidomos me bashkëmoshatarët, si një prirje e natyrshme e jetës së përditshme.
- » Të dhënat sasiore të studimit treguan se përgjithësisht përfshirja e vajzave në konflikte ose sjellje devijante është më e vogël në krahasim me atë të djemve. Në qytet pesha specifike e të miturve dhe të rinjve që përfshihen në konflikte është më e madhe krahasuar me atë në fshat dhe në zonat periferike. Gjithashtu, vihet re se grupi i të miturve dhe të rinjve me arsim 9-vjeçar dhe të ardhura mesatare familjare ka pohuar më së shumti se përfshihet në konflikte në krahasim me grupet e tjera.
- » Studimi nxori në pah se 652 nga 1037 të anketuar kanë pohuar se janë informuar për drejtësinë restauruese, por vetëm 28.4 për qind e tyre janë përfshirë dhe kanë përfituar nga ky program.
- » Interesant paraqitet fakti se ndër të miturit dhe të rinjtë që janë në proces gjykimi dhe akuzohen për kryerjen e ndonjë kundërvajtjeje penale, 59.5 për qind kanë informacion për ndërmjetësimin dhe drejtësinë restauruese dhe 25 për qind e këtyre të miturve dhe të rinjve që janë në proces gjykimi kanë përfituar nga ky program.
- » Pjesa më e madhe e të miturve, që janë përgjigjur se kanë përfituar nga shërbimi i ndërmjetësimit dhe programi i drejtësisë restauruese, janë anëtarë të bashkësisë rome (40 për qind e të anketuarve nga bashkësia rome) dhe të mitur dhe të rinj në paraburgim dhe të dënuar (35.1 për qind e të miturve dhe të rinjve në paraburgim dhe të dënuar), kategori të cilat, përveç të tjerash kanë qenë në vëmendje të programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit.
- » Të dhënat e ndara sipas tri kategorive të të anketuarve, nxorën në pah se të miturit dhe të rinjtë në paraburgim e të dënuar (48.5 për qind), si dhe ata në shkollë (49.5 për qind) mendojnë se një anëtar i familjes përbën personin më të përshtatshëm për t'i ndihmuar ata në rast konflikti, ndërsa të anketuarit nga bashkësia rome, në një pjesë të madhe të rasteve (33.7 për qind), i besojnë një ndërmjetësi profesionist dhe të paanshëm.
- » Të dhënat e anketimit nxorën, gjithashtu, në pah se pavarësisht nëse kanë përfituar ose jo nga këto programe, të miturit dhe të rinjtë e anketuar (rreth 85 për qind) janë të gatshëm të pranonin procesin e zgjidhjes së konfliktit përmes ndërmjetësimit dhe të përfshiheshin në programin e drejtësisë restauruese për zgjidhjen e konflikteve të tyre.
- » Gjithashtu, një pjesë po kaq e rëndësishme e pjesëmarrësve në procesin e anketimit (87 për qind ose 856 të anketuar) ka pohuar se do të ishin të gatshëm t'ia rekomandonin shërbimin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë restauruese miqve dhe të afërmve të tyre.

- » Studimi nxori në pah se ka një shkallë të ulët të ndërgjegjësimit të të miturve dhe të rinjve për efektet pozitive parandaluese të dialogut restaurues në uljen e mundësisë për t'u përfshirë në konflikte dhe kundërvajtje penale dhe shmangien e recidivizmit, çka mbetet një sfidë për t'u kapërcyer. Rreth 52.7 për qind e të anketuarve pohojnë se nuk e dinë nëse përfshirja në procesin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë restauruese do të kishte shmangur kryerjen e kundërvajtjes penale.

Nga ana tjetër, nga *intervistat e drejtpërdrejta, si dhe fokus grupet* me profesionistë të fushës, studimi nxori në pah se:

- » Një përfundim i nxjerrë është se të miturit ose të rinjtë që përfshihen në situata konfliktuese më të rënda, si vepra ose kundërvajtje penale, vijnë kryesisht nga shtresa të marginalizuara shoqërore, nga grupe të varfëra ose dhe nga familje me status socio-ekonomik më të ulët krahasuar me numrin e përgjithshëm të të miturive dhe të rinjve që morën pjesë në studim. Më tepër se nga procesi i anketimit, ky përfundim nxirret nga intervistat e thelluara me ekspertë të fushës që trajtojnë të mitur dhe të rinj në kontakt me ligjin.
- » Një pjesë e të intervistuarve kanë informacion për drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin dhe janë trajnuar për to, madje dhe janë përfshirë si bashkëpunëtorë në ofrimin e programit të drejtësisë restauruese. Ka dhe një pjesë profesionistësh të rinj që nuk kanë informacion dhe e konsiderojnë me interes rritjen e informacionit në këtë fushë.
- » Të intervistuarit raportojnë se drejtësia restauruese krijon mundësinë që të arrihet një ekuilibër mes nevojave të viktimës, autorit, dhe bashkësisë, duke i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e drejtësisë sa më shumë që të jetë e mundur të gjitha palët.
- » Të intervistuarit vlerësojnë se programet e drejtësisë restauruese zvogëlojnë edhe mundësinë e recidivizmit të të miturit.
- » Drejtësia restauruese konsiderohet nga të intervistuarit si alternativë që duhet të njihet dhe përdoret më shpesh veçanërisht për të miturit në kontakt me ligjin, por jo vetëm, mbart në vetvete parandalim të përshkallëzimit të situatës konfliktuese, normalizim të marrëdhënieve njerëzore, kursim të kohës dhe të shpenzimeve etj.
- » Edhe shkolla konsiderohet nga të intervistuarit një institucion i rëndësishëm për zhvillimin e procesit të ndërmjetësimit, duke qenë se kjo alternativë rrit mundësitë e parandalimit të problemit. Të intervistuarit raportojnë disa raste ku shkollat kanë kërkuar mbështetjen nga persona të trajnuar të programit për të zgjidhur konfliktet, pa pasur të nevojshme që t'i referojnë raste të tilla në polici.
- » Të intervistuarit raportojnë, gjithashtu, se nevoja e pjesëmarrjes së bashkësisë në ndërhyrjet restauruese është e një rëndësie parësore. Ata theksojnë se, aktualisht, përfshirja e bashkësisë mungon në shumicën e rasteve. Ndërgjegjësimi i bashkësisë vlerësohet tepër i domosdoshëm.
- » Identifikimi i faktorëve mbrojtës (të brendshëm) të të miturve ndihmon që të zbatohet më lehtë drejtësia restauruese. Disa nga faktorët mbrojtës të identifikuar dhe të raportuar nga

të intervistuarit janë: motivimi për arritje të mira në shkollë, ndershmëria, përgjegjshmëria, aftësi ndër-vetjake, aftësi për të zgjidhur konflikte, vështirimi pozitiv për të ardhmen.

- » Studimi, gjithashtu, nxori në pah se njohja e faktorëve mbrojtës të jashtëm është tepër e rëndësishme për zbatimin e drejtësisë restauruese të të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin. Sipas të intervistuarve këta faktorë lidhen edhe me një element të rëndësishëm që ka të bëjë me përfshirjen e bashkësisë dhe të aktorëve të tjerë të jashtëm që krijojnë një terren të përshtatshëm për zbatimin e drejtësisë restauruese.
- » Të intervistuarit nxorën në pah se ndërhyrja e duhur për të miturit, që kanë kryer veprën e parë penale, është shmangia nga sistemi i drejtësisë penale dhe mbështetja nga programe rehabilituese dhe të drejtësisë restauruese.
- » Të dhënat cilësore të studimit nxorën në pah se kombinimi i politikave penale me politikat e tjera në fushën e arsimimit, të mbështetjes dhe fuqizimit të familjes, të shëndetit mendor, të aftësisë profesionale dhe të punësimit të të rinjve shihen si ndërhyrjet më të përshtatshme dhe efektive për uljen e recidivizmit të të miturit. Pjesa më e madhe e të intervistuarve raportojnë një mungesë të shërbimeve kur të miturit përfundojnë vuajtjen e dënimit dhe dalin nga institucioni.
- » Raportohet ose nxirret si përfundim gjatë studimit një nivel i ulët bashkëpunimi dhe angazhimi i aktorëve të ndryshëm për trajtimin e nevojave të të miturve. Në zinxhirin e shërbimeve, që ofrohen për të miturit, jo të gjithë ofruesit e shërbimeve japin kontributin e duhur për trajtimin e nevojave të të miturve. Të intervistuarit pohojnë se sistemi i drejtësisë restauruese ndihmon në përmbushjen e disa nevojave kryesore të të miturve dhe të rinjve, autorë të veprave penale, ndër të cilat më e rëndësishmja është inkurajimi në jetën në bashkësi.
- » Përgjithësisht të intervistuarit në të gjitha institucionet e sipërpërmendura vlerësojnë pozitivisht ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimin dhe përfshirjen e të miturve në programet e drejtësisë restauruese, duke i konsideruar ato, jo vetëm si zgjidhës praktikë të çështjeve dhe konflikteve konkrete jashtë rrugës gjyqësore, por mbi të gjitha si një proces edukimi, pasojat e të cilit duhen parë në perspektivë afatgjatë dhe jo me lente përditshmërie.

6. REKOMANDIME

Kur flasim për aktorët të cilët mund të ndikojnë drejtpërdrejt në zbatimin e drejtësisë restauruese, lista është mjaft e gjerë, por mund të bëhet një grupim në katër kategori kryesore: 1) Institucionet shtetërore të sistemit të drejtësisë dhe arsimit; 2) organizatat e shoqërisë civile; 3) media; 4) organizmat ndërkombëtarë. Nga studimi mund të nxirren disa rekomandime për secilin nga këto grupime aktorësh.

Rritja e ndikimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe të arsimit në zbatimin e drejtësisë restauruese

- Ofrimi i shërbimit të drejtësisë restauruese dhe i ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës dhe takimit në grup (community conferencing), për të miturit në kontakt me ligjin dhe më gjerë, kërkon standardizimin e legjislacionit penal për të miturit. Profesionistët e fushës së drejtësisë për të mitur dhe asaj sociale rekomandojnë ndryshime të thella në legjislacionin për të mitur me synim rritjen e aksesit të të miturve nga drejtësia. Kjo do të kërkonte harmonizimin e legjislacionit penal që trajton çështje të devijimit/referimit të rasteve të konflikteve nga institucionet e drejtësisë penale dhe trajtimit përmes shërbimit alternativ të zgjidhjes siç është ndërmjetësimi dhe drejtësia restauruese, duke bërë të mundur shmangien e rrugës gjyqësore.
- Të investohet më shumë për aftësim dhe ngritje të kapaciteteve të profesionistëve, të cilët merren me menaxhim konfliktesh penale të fokusuar kryesisht te të miturit, por jo vetëm (si të punonjësve dhe oficerëve të policisë, prokurorëve, gjyqtarëve, punonjësve të sistemit të parburgimit dhe burgjeve, të punonjësve dhe specialistëve të shërbimit të provës etj).
- Ky aftësim do të mundësohej përmes organizimit të programeve edukuese dhe trajnuese në fushën e zgjidhjes alternative të konflikteve penale, duke njohur dhe zbatuar instrumentin e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës, i fokusuar kryesisht për të miturit në kontakt me ligjin.
- Të zhvillohen programe edukuese me natyrë parandaluese në institucionet shkollore të arsimit parauniversitar për sjelljet antisociale dhe konfliktuese në grupmoshat shkollore. Programe të tilla me fokus dialogun restaurues dhe ndërmjetësimin midis bashkëmoshatarëve, si pjesë e veprimtarive ekstrakurrikulare, por edhe kurrikulare, do të kishin një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e situatës konfliktuese dhe parandalimin e dhunës në mjediset shkollore.
- Të krijohen mekanizmat e nevojshëm të bashkëpunimit institucional, për të rritur angazhimin e aktorëve të ndryshëm të sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur dhe sistemit social (policisë, prokurorisë, gjyqësorit dhe sistemit të shërbimit social) për trajtimin e nevojave të të miturve, veçanërisht të atyre që përfshihen në situata konfliktuese dhe veprimtari kriminale. Ofrimi i ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës dhe i programit të drejtësisë restauruese në përgjithësi duhet të përbëjnë një hallkë të rëndësishme në procesin bashkëpunues.

Rritja e ndikimit tek *organizatat e shoqërisë civile në zbatimin e drejtësisë restauruese*

- Organizatat e shoqërisë civile duhet të bëjnë më shumë për të rritur nivelin e informimit, ndërgjegjësimit dhe edukimit të grupeve të interesuara dhe publikut të gjerë rreth formave alternative të zgjidhjes së konflikteve penale veçanërisht kur përfshihen të mitur. Vëmendje në këtë proces duhet t'i kushtohet promovimit të vlerave pozitive që mbart zbatimin e instrumentit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës, si dhe takimi në grup në raport me format e tjera të ndëshkimit penal për të miturit.
- Të bëhet më i qartë roli lobues nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesuar tek institucionet shtetërore dhe komisioni i ligjeve në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë për ndryshimet dhe përmirësimet ligjore për administrimin e drejtësisë për të mitur dhe veçanërisht të përfshirjes së praktikave të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi.
- Përvoja e fituar dhe ekspertiza e ngritur ndër vite e arritur në sajë të mbështetjes së donatorëve të ndryshëm të bëhet pjesë e bashkëpunimit në programet e trajnimit për ngritjen e kapaciteteve, sidomos për stafet e institucioneve që kanë në fokus të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin.
- Të punohet më shumë për arritjen e bashkëpunimeve dhe krijimin e sinergjive të reja ndërmjet aktorëve të shoqërisë civile që kanë në fokusin e punës së tyre të miturit dhe të rinjtë në kontakt me ligjin, me synim praktikimin e drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimi në bashkëpunimet institucionale dhe më gjerë.
- Duke qenë se shërbimi i ndërmjetësimi nuk mund të ofrohet si pjesë e strukturave shtetërore, për shkak të pavarësisë dhe paanësisë së profesionit, rekomandohet që organizatat e shoqërisë civile që kanë në objektin e tyre të punës programe të ndërmjetësimi dhe drejtësisë restauruese, ta mbështesin ofrimin e këtij shërbimi falas për shtresat në nevojë dhe për grupet e të miturve.
- Programet e drejtësisë restauruese duhet të kenë në fokus jo vetëm kategorinë 14-21 vjeç, por edhe atë 12-14 vjeç, të cilët i shpëtojnë drejtësisë penale, por përbëjnë kontingjent për t'u përfshirë në kategorinë e të rinjve devijantë në një të ardhme jo të largët.
- Gjithashtu, zhvillimi i programeve të parandalimit të hershëm dhe të trajtimit të hershëm të sjelljes kriminale është i një rëndësie parësore për uljen e nivelit të sjelljeve devijante të të rinjtë dhe të miturit në kontekstin shqiptar, si dhe për uljen e nivelit të recidivizmit të kjo kategori. Nëpërmjet programeve të ndryshme organizatat e shoqërisë civile duhet të krijojnë ura bashkëpunimi, për të forcuar bashkëpunimin familje-shkollë-bashkësi. Ofrimi i programeve të drejtësisë restauruese do të kishte një rëndësi të veçantë për arritjen e këtij qëllimi.
- Ofrimi i shërbimeve mbështetëse me natyrë riintegruese për të mitur edhe pas përfundimit të dënimit është i një rëndësie parësore. Rekomandohet që bashkëpunimi i organizatave të shoqërisë civile me strukturat shtetërore dhe me ato të fushës së biznesit do ta rriste

shumëllojshmërinë dhe cilësinë e këtyre shërbimeve. Përfshirja e programeve për këtë kategori të miturish dhe të rinjsh me fokus drejtësinë restauruese mbetet e një rëndësie parësore.

Roli i medias në zbatimin e drejtësisë restauruese

- Niveli i informacionit rreth drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për publikun në përgjithësi është i një rëndësie parësore. Media, qoftë ajo elektronike, por edhe ajo e shkruar mund dhe duhet të luajnë një rol shumë të rëndësishëm si në shtimin e informacionit, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut për vlerat që mbart drejtësia restauruese. Kjo mund të bëhet konkretisht me anë të ofrimit të programeve të veçanta televizive, rubrikave në gazeta etj. që kanë në fokus promovimin e drejtësisë restauruese.

Roli i organizmave ndërkombëtarë në zbatimin e drejtësisë restauruese

- Organizmat ndërkombëtarë duhet të vazhdojnë të mbështesin programet e drejtësisë restauruese në kontekstin shqiptar. Sikurse u përmend edhe më sipër, ende mbeten shumë sfida për t'u kapërcyer për njohjen dhe përvetësimin e parimeve të drejtësisë restauruese nga shoqëria shqiptare.
- Përçimi i përvojës pozitive ndërkombëtare dhe modeleve të suksesshme nga shoqëritë e zhvilluara për zbatimin e drejtësisë restauruese nga organizmat ndërkombëtarë përbën një element shumë të rëndësishëm që ndihmon zbatimin me sukses të drejtësisë restauruese në Shqipëri.

7. BIBLIOGRAFIA

Chung, H. L. dhe Lawrence Steinberg (2006). Relations between neighborhood factors, parenting behaviors, peer deviance, and delinquency among serious juvenile offenders, *Developmental Psychology*, 42, 319-331.

Creswell, J. W. (2003). *Research design: Qualitative, quantitative, and mixed methods approaches* (2nd ed.). Thousand Oaks, CA: Sage.

Dervishi, Z. (2002). *Adoleshentët, bashkëjetesë me demonët e konflikteve*, Tiranë. SH.B. Jerusalem.

Frederick, B. (1999). Factors contributing to recidivism among youth placed with the NY State Division for Youth. Albany, NY: Office of Justice Systems Analysis, NY State Division of Criminal Justice Services.

Giddens, A. (Përkth. Starova, T., Myftiu, K.) (2004). *Sociologjia*. Çabej. Tiranë

Gjoka, R. (2011). Roli dhe nevojat e viktimave, autorëve të veprave penale dhe komunitetit në programet e fushat e zbatimit të drejtësisë restauruese. *Te drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit*, Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve.

Halcomb, E., Andrew, S., (2005). Triangulation as a method for contemporary nursing research. *Nurse Researcher*. 13, 2, 71-82.

Hayes, H., dhe Daly, K. (2003). Youth justice conferencing and re-offending. *Justice Quarterly*, 20(4), 725-764.

Howard, Z. (2002). *The little book of Restorative Justice*. Intercourse, PA: Good Books.

Katsiyannis, A. dhe Archëamety, T., (1997). Factors related to recidivism among delinquent youths in a state correctional facility, *Journal of Child and Family Issues*, 6, 43-55

Latimer, J., Dowden, C., dhe Muise, D. (2005). The effectiveness of restorative justice practices: A meta-analysis. *The Prison Journal*, 85(2), 127-144.

Ligji shqiptar “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve” nr. 10385, datë 24.02.2011.

Mathison, S. (1988). Why triangulate? *Educational Researcher*, 17(2), 13-17.

Maxwell, G., dhe Morris, A. (2001). Family group conferences and re-offending. In A. Morris & G. Maxwell (Eds.), *Restorative justice for juveniles: Conferencing, mediation and circles*.

Semini, M. (2011). Parimet e përdorimit të drejtësisë restauruese në çështjet penale, roli i ndërmjetësit dhe aftësitë e tij te drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi për të miturit. *Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve*.

Sherman, L., Strang, H., dhe Woods, D. (2000). Recidivism patterns in the Canberra Reintegrative Shaming Experiments. Canberra: Australian National University, Centre for Restorative Justice, Research School of Social Sciences.

Williamson, G.R. (2005). Illustrating triangulation in mixed-methods nursing research. *Nurse Researcher* 12, 4, 7-18.

8. SHTOJCA

Shtojca 1: PYETËSOR

Ky pyetësor po përdoret në kuadrin e studimit “Të miturit në kontakt me ligjin dhe efektet e zbatimit të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit” të zhvilluar nga Fondacioni për Zgjidhjen e Konfliktëve dhe Pajtimin e Mosmarrëveshjeve dhe Save the Children, me mbështetjen e Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri.

Ju sigurojmë se informacioni juaj është konfidencial dhe do të përdoret vetëm për arsye studimore.

Seksioni 1: Të dhëna vetjake

1. **Mosha aktuale:** 1. 14-15 2. 16-17 3. 18-19 4. 20-21
2. **Seksi:** 1. Femër 2. Mashkull
3. **Qarku ku banoni:** 1. Tiranë 2. Durrës 3. Vlorë 4. Korçë 5. Lezhë 6. Shkodër 7. Tjetër _____
4. **Banoni në:** 1. Qytet 2. Fshat 3. Zonë periferike
5. **Numri i anëtarëve në familje (përfshirë dhe ju):** 1. 1-2 2. 3-4 3. 5-6 4. Më shumë se 6
6. **Statusi i prindërve tuaj:** 1. Të Martuar 2. Të Divorcuar 3. i/e Ve 4. Të vdekur 5. i/e rimartuar
7. **Jetoni:**
 1. Me të dy prindërit
 2. Me të dy prindërit, motra e vëllezër
 3. Me të dy prindërit, motra e vëllezër dhe gjyshërit
 4. Vetëm me nënën
 5. Vetëm me babanë
 6. Me njërin nga prindërit dhe motra e vëllezër
 7. Me njërin nga prindërit, motra e vëllezër dhe gjyshin/gjyshen
 8. Me të afërm
 9. Vetëm, pa kujdesin e të rriturve
 10. Tjetër _____

8.	Niveli juaj arsimor i përfunduar:	1. Pa arsim	2. Fillor	3. 9-vjeçar	4. I mesëm	5. Universitar	6. Pasuniversitar	7. Pa përgjigje
9.	Niveli arsimor i përfunduar i babait tuaj:	1. Pa arsim	2. Fillor	3. 8-vjeçar	4. I mesëm	5. Universitar	6. Pasuniversitar	7. Nuk e di / Pa përgjigje
10.	Niveli arsimor i përfunduar i nënës suaj:	1. Pa arsim	2. Fillor	3. 8-vjeçar	4. I mesëm	5. Universitar	6. Pasuniversitar	7. Nuk e di / Pa përgjigje

11. Ju lutem identifikoni të ardhurat e familjes suaj:

1. Shumë të mira 2. Mesatare 3. Të pakta 4. Tjetër_____

12. Në familjen tuaj punon:

1. Babai dhe nëna
2. Nëna, babai dhe ju
3. Vetëm babai
4. Vetëm nëna
5. Njëri nga prindërit
6. Njëri nga prindërit dhe ju
7. Vetëm ju
8. Asnjë
9. Tjetër_____

13. Si do ta vlerësonit marrëdhënien me familjen:

1. Shumë mirë
2. Mirë
3. Jo keq
4. Keq

Seksioni 2: Konflikti, sjellja devijante dhe dënimi**14. Jeni përfshirë në konflikt, ose keni kryer sjellje devijante kundrejt:**

1. Bashkëmoshatarëve
2. Individëve më të rritur se ju
3. Anëtarëve në familje
4. Institucioneve
5. Tjetër _____

15. Keni kryer (ose jeni akuzuar për) ndonjë veprë penale për të cilën jeni dënuar?

1. Po
2. Jo

(Shënim: Nëse përgjigja është PO, vazhdo në pyetjen pasuese, nëse JO, kalo te pyeja nr. 20)

16. Nëse po, ç' veprë penale keni kryer (ose jeni akuzuar)?

1. Vjedhje
2. Plagosje
3. Fyerje
4. Kanosje
5. Trafikim lëndësh narkotike
6. Falsifikim dokumentesh
7. Tjetër _____

17. Ç'dënim keni marrë për këtë veprë penale?

1. Jam në proces gjykimi
2. Jam dënuar me heqje lirie
3. Jam dënuar me kusht
4. Punë të detyruar në interes publik
5. Tjetër _____

18. Sa herë jeni dënuar?

1. Asnjë herë
2. Vetëm një herë
3. Dy herë
4. Më shumë se dy herë

19. A është dënuar ndonjëherë ndonjë prej anëtarëve të familjes suaj për kryerjen e ndonjë veprë penale?

1. Jo
2. Po

Seksioni 3: Informacioni dhe perceptimi për drejtësinë restauruese

20. Nëse përfshiheni në një situatë konfliktuese ose kundërvajtje penale, do të parapëlqenit:

1. T'i drejtoheshit rrugës ligjore
2. T'i drejtoheshit një pale të tretë profesioniste dhe të paanshme jashtë sistemit gjyqësor
3. Ta zgjidhni çështjen me anë të familjes/shokëve/të afërmeve
4. Ta shtynit për më vonë vetëgjyqësinë/hakmarrjen
5. Ta falnit/harronit
6. Tjetër_____

21. Cila është arsyeja kryesore pse shikoni me përparësi këtë alternativë të zgjidhjes së çështjes tuaj?

1. Sepse çështja zgjidhet më mirë
2. Sepse çështja zgjidhet më shpejt
3. Sepse çështja zgjidhet pa shpenzime financiare
4. Sepse keni më shumë besim te kjo rrugëzgjidhje
5. Tjetër_____

22. A keni dëgjuar ndonjëherë për zgjidhje të mundshme jashtë rrugës gjyqësore si: ndërmjetësimin viktimë-kundërvajtës, dialogun ose drejtësinë restauruese?

1. Po
2. Jo

(Shënim: Nëse përgjigjja është PO, vazhdo në pyetjen pasuese, nëse JO, kalo te pyetja nr. 26)

23. Nëse po, nga e keni marrë informacionin?

1. Nga media
2. Nga punonjës policie
3. Nga të njohur/fqinj/miq
4. Nga ndërmjetës
5. Nga broshura informuese
6. Tjetër_____

24. A keni përfituar ju nga ky shërbim?

1. Po
2. Jo

25. A ka përfituar ndonjë i afërmi juaj nga ky shërbim?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

26. Konfliktin, në të cilin keni qenë të përfshirë a e konsideroni të zgjidhur?

1. Po 2. Jo

(Shënim: Nëse përgjigjja është PO, vazhdo në pyetjen pasuese, nëse JO, kalo te pyetja nr. 29)

27. A keni komunikuar me palën që keni qenë të konfliktuar, pasi e keni zgjidhur konfliktin me mirëkuptim?

1. Po 2. Jo

(Shënim: Nëse përgjigjja është PO, vazhdo në pyetjen pasuese, nëse JO, kalo te pyetja nr. 29)

28. Nëse po, sa herë jeni takuar me palën tjetër?

1. Shpesh 2. Kur na bie rasti 3. Rrallë

29. Kush mendoni se është personi më i përshtatshëm që ju ndihmon në zgjidhjen e një konflikti?

1. Një anëtar i familjes
2. Një shok
3. Një ndërmjetës profesionist i paanshëm
4. Një punonjës policie
5. Një mësues
6. Një avokat
7. Punonjësi social
8. Psikologu
9. Tjetër _____

30. A do ishit i gatshëm të pranoni procesin e zgjidhjes së konfliktit përmes ndërmjetësimit dhe të përfshiheshit në programin e drejtësisë restauruese për zgjidhjen e konflikteve tuaja?

1. Po 2. Jo

31. A do ishit i gatshëm t'ia rekomandonit shërbimin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë restauruese miqve dhe të afërmve tuaj?

1. Po 2. Jo

32. A mendoni se po të ishit përfshirë më parë në procesin e ndërmjetësimit dhe programin e drejtësisë restauruese do të kishit shmangur kryerjen e kundërvajtjes penale (nëse ka kryer)?

1. Po 2. Jo 3. Nuk e di/Pa përgjigje

FALEMINDERIT!

Shtojca 2: UDHËZUESI I INTERVISTAVE

- Cilat janë veprat penale në të cilat përfshihen më së shumti të miturit që trajtohen në institucionin tuaj?
- Cilët janë profesionistët/ aktorët e tjerë me të cilët ju bashkëpunoni për trajtimin e rasteve të të miturve dhe konkretisht në çfarë rastesh?
- A ka pasur raste të miturish që kanë përsëritur përfshirjen në konflikte penale dhe nëse po, në ç'masë do ta vlerësonit ju këtë recidivizëm? Si procedohet në këto raste? A mundësoni ju një trajtim të veçantë për këtë kategori të miturish?
- Në ç'masë përfshihen si bashkëpunëtorë me ju prindërit e fëmijëve në kontakt me ligjin? A bëni ju një analizë të kontekstit social dhe familjar të këtyre fëmijëve?
- Si mendoni ju se mund të ulet niveli i recidivizmit për kategorinë e të miturve në Shqipëri?
- A përfshihen në punën tuaj programe/procedura/aktivitete konkrete që synojnë ndërgjegjësimin e të miturve për rrezikun e përfshirjes në konflikte penale dhe mospërsëritjen e tyre?
- A njihni ju programe të veçanta që synojnë edukimin e të miturve në kontakt me ligjin me synim uljen e nivelit të recidivizmit dhe shkallën e konfliktualitetit në shoqëri?
- Keni dëgjuar për drejtësinë restauruese dhe shërbimin e ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës? Nëse po, ç'mendim keni për efikasitetin e tyre?
- A ofrohet ky shërbim në institucionin tuaj? A jeni përfshirë ju si bashkëpunëtorë në këtë proces? A keni marrë trajnime në lidhje me DR dhe ndërmjetësimin VO?
- Sipas mendimit tuaj cilat janë disa nga sfidat e përfshirjes së të miturve në programe të drejtësisë restauruese? Çfarë duhet përmirësuar brenda dhe jashtë sistemit në të cilin ju punoni?